



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 30 regjistër (JR)
Datë 06.11.2018

Nr. 18 i vendimit
Datë 26.07.2019

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Natasha Mulaj	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Luan Daci	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 26.07.2019, ora 09:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 30, datë 06.11.2018, që i përket:

Ankues: Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

Objekti: Shqyrtimi i vendimit nr. 43, datë 18.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Nertina Kosova.

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seanca publike¹, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 43, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me arsyetim të ndryshuar, për subjektin e rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, e cila kërkoi përfundimisht lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

¹ Të zhvilluara në datat: 12.06.2019, 21.06.2019, 26.06.2019, 03.07.2019, 12.07.2019, 29.07.2019 dhe 22.07.2019. Vendimi përfundimtar u shpall më datë 26.07.2019.

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, iu nënshtua procesit të rivlerësimit me përparësi, *ex officio*, për shkak të kandidimit të saj për anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Subjekti i rivlerësimit është bërë subjekt deklarues në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”) në vitin 2003. Në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”) i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim “ligji nr. 9367/2005”) i ndryshuar, subjekti ka dorëzuar ndër vite deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë, vitet 2003-2016, si dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar për efekt të ligjit nr. 84/2016 (në vijim “deklarata *vetting*”), brenda afatit ligjor (dorëzuar pranë ILDKPI-së më datë 24.01.2017).
3. ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016², i ka dërguar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit raportin përfundimtar, duke konstatuar se:
 - i. deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - ii. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - iv. nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit dhe ka hartuar raportin përkatës, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.
5. Këshilli i Lartë i Drejtësisë (në vijim “KLD”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale dhe në përfundim i ka dërguar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit raportin përfundimtar. Relatori i çështjes pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i propozoi trupit gjykues që subjekti i rivlerësimit të klasifikohet si “e aftë”.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

6. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), me vendimin nr. 43, datë 18.07.2018, ka vendosur: “[...] Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, Tiranë [...]”.

6.1. Vendimi i mësipërm (nr. 43/2018) i Komisionit është bazuar në vlerësimin e të tria kriterëve të rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.³

² Shkresa nr. {***} prot., datë 13.11.2017.

³ Neni 4, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

Më konkretisht, pasi ka administruar të tria raportet e vlerësimit – raportin përfundimtar të ILDKPKI-së, raportin e DSIK-së dhe raportin e KLD-së – dhe pasi ka shqyrtuar provat dhe ka dëgjuar publikisht subjektin e rivlerësimit, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, Komisioni ka konkluduar sa vijon.

6.2. Për vlerësimin e pasurisë: [...] *Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.*

Komisioni arsyetoi se:

- nga analiza financiare rezultoi që subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e shumës 1.000.000 (një milion) lekë, si pjesë e investuar prej saj në blerjen e pasurisë apartament banimi, me sipërfaqe 120 m², me adresë në rrugën “{***}”, Tiranë; që nuk ka dyshime mbi këtë pasuri dhe që deklarimi i subjektit përputhet me verifikimin e kryer;
- babai i subjektit transferoi shumën prej 303.972 lekësh në llogarinë personale të subjektit më datë 13.11.2008, nga llogaria e përbashkët që ai kishte me subjektin e rivlerësimit. Komisioni vërejtë se subjekti nuk e kishte deklaruar këtë transfertë në deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë për vitin 2008, ndërkohë që në pyetësin nr. 4, datë 12.06.2018, subjekti ka konfirmuar këtë shumë për vitin 2008, si shumë e rrjedhur nga mbyllja e depozitës dyemërore. Në këto kushte, nuk ka dyshime mbi këtë transfertë;
- nga korrespondenca me institucionet bankare, u konstatua kalimi i disa shumave monetare nga znj. E.S. për llogari të subjektit të rivlerësimit, respektivisht në vitet 2009-2013, të cilat janë shuma relativisht të vogla, në periudha kohore të ndryshme dhe konkretisht të realizuara nga një person i afërt familjar (kunata e saj/nusja e vëllait);
- lidhur me likuiditetet në emër të subjektit, depozita bankare ose llogari rrjedhëse, gjendje deri në 18 janar 2017, pranë Bankës “Raiffeisen” konstatohet se subjekti ka qenë i saktë në deklaratimin e tij;
- nga analiza financiare rezultoi se subjekti ka pasur mundësi të mbledhë kursime ndër vite, që kanë çuar në krijimin e pasurisë “likuiditet”, të deklaruar në deklaratën *vetting*;
- lidhur me kredinë për blerje banese pranë Bankës “Raiffeisen”, datë 17.12.2005, në vlerën 5.000.000 lekë, disbursuar më datë 27.12.2005, rezultoi se nuk ka pasaktësi në deklarime dhe dyshime për këtë detyrim financiar.

6.3. Për kontrollin e figurës: [...] *Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e pasurisë.*

Nga hetimi administrativ në Komision, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nuk u konstatua të ketë pasaktësi apo deklarime të rreme në plotësimin e formularit për kontrollin e figurës, sipas nenit 39 të ligjit nr. 84/2016. Për subjektin e rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, vlerësohet se është në kushtet e përshtatshme për vazhdimin e detyrës si gjyqtare.

6.4. Për vlerësimin e aftësive profesionale: [...] *Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të lartë të vlerësimit të aftësive profesionale.*

Pas hetimit nga Komisioni të raportit të Grupit të Punës në KLD dhe denoncimeve, nuk u gjet asnjë indicie apo element që mund të ngrejë dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarës, znj. Nertina Kosova, duke propozuar vlerësimin “e aftë”.

III. Shkaqet e ankimit

7. Komisioneri Publik, më datë 24.09.2018⁴, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 43, datë 18.07.2018, që lidhet me subjektin e rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të dhe kërkoi kryerjen e një hetimi dhe vlerësimi mbi burimin e ligjshëm, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimit të pasurisë/likuiditetet. Në ankim, në përfundim të gjykimit të çështjes, Komisioneri kërkoi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”), të vendosë ndryshimin ose lënien në fuqi të vendimit të Komisionit. Sipas ankimit, hetimi i Komisionit nuk ka qenë i plotë dhe i gjithanshëm për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë së saj, në kuptim të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
8. Në konkluzionet përfundimtare të çështjes, të parashtruara në seancën e datës 22.07.2019, në vlerësimin tërësor të të gjithë provave të administruara gjatë shqyrtimit dhe hetimit gjyqësor të çështjes, Komisioneri Publik i kërkoi Kolegjit lënien në fuqi me një tjetër arsyetim të vendimit nr. 43, datë 18.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Nertina Kosova.

A. Shkaqet e ankimit për vlerësimin e pasurisë

9. Në mënyrë të përmblodhur, shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten si më poshtë.
 - 9.1. *Për pasurinë: "Apartament me sipërfaqe 120 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë:*
 - i) Hetimi i Komisionit është i mangët dhe nuk është kryer analizë financiare sa i takon diferencës prej 500.000 lekësh për pagesat e shumave respektive: 1.500.000 lekë, qarkulluar në dhjetor të 2005-ës për porositjen e apartamentit nga shoqëria “{***}” ShPK dhe shumës prej 1.000.000 lekësh, marrë nga i ati në shtator të vitit 2006 për blerjen e apartamentit.
 - ii) Në kuptim të nenit 3, pika 13 dhe nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, babai i subjektit të rivlerësimit kategorizohet si person i lidhur dhe, duke qenë se nga subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, deklarohet se të ardhurat e saj kanë shërbyer për krijimin e likuiditeteve sipas gërmës “a” më lart, nën regjimin e ekonomisë së përbashkët familjare, në zbatim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni duhet t’i kalonte subjektit barrën e provës për të gjitha likuiditetet e padeklaruara, të cilat kanë rezultuar nga hetimi administrativ, përfshirë këtu edhe depozitën bankare në emër të babait, në vlerën 1.900.000 lekë, në Bankën “Societe Generale Albania”.
 - iii) Duke qenë se subjekti i rivlerësimit pranon se likuiditetet si më sipër, kanë pasur burim krijimi kursimet familjare dhe të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, të depozituara në formë kontributi në familje, Komisioni duhet të kishte kryer analizë financiare në lidhje me mundësinë e krijimit të kursimeve të subjektit dhe të personave të lidhur, nga burime të ligjshme, duke pasur parasysh faktin që (i) babai rezulton se nga data 01.04.1997 përfiton pension invaliditeti (shih vërtetimin e ISSh - Dega {***} nr. {***} prot., datë 13.10.2013), (ii) nëna, sipas vërtetimit të

⁴ Shkresa nr. {***} prot., datë 24.09.2018 – shih <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/10/10.Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-43-dat%C3%AB-18.7.2018-t%C3%AB-KPKp%C3%ABr-subjektin-e-rivler%C3%ABsimit-znj.-Nertina-Kosova.pdf>

ISSh-Dega {***} nr. {***} prot., datë 06.07.2018, përfiton të ardhura të ulëta mujore deri në vitin 2010, kur i lind e drejta për përfitimin e pensionit të pleqërisë, (iii) vëllai, z. K.K., rezulton se krijon të ardhura të ligjshme pas emërimit të tij si kryetar i Degës së Policisë Ndërtimore {***}, më datë 27.12.2005.

- iv) Nuk është kryer hetim i plotë lidhur me transfertat bankare të vëllait të subjektit të rivlerësimit, e konkretisht lidhur me dy derdhje *cash*, përkatësisht 20.000 USD dhe 2.350 USD, total 22.350 USD në datën 06.04.2005, me përshkrim “derdhje *cash* K.K.”, shuma këto të transferuara në një llogari bankare jashtë vendit.
- v) Komisioni rezulton se është ndalur vetëm në vlerësimin e aftësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për shumën 1.000.000 lekë, pa konsideruar likuiditetet e tjera të personave të lidhur me të, babai dhe vëllai, duke mos përmbushur në këtë mënyrë detyrimin kushtetues të përcaktuar në Nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 32, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni, marrëdhënien e posaçme familjare dhe kontributin e përbashkët në krijimin e të ardhurave në rastin konkret, duhet ta adresonte dhe hetonte nën regjimin ligjor të personave të lidhur apo personave të tjerë të lidhur, për sa kohë nga kjo marrëdhënie shfaqet interesi pasuror i subjektit të rivlerësimit, produktet e të cilit duhet të justifikohen ligjërisht gjatë procesit të rivlerësimit.

9.2. Për huan e marrë nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. Q.K., ndaj shtetasit G.S.:

- i) Deklarimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me huan e marrë nga babai, z. Q.K., ndaj shtetasit G.S., në vlerën 7.000.000 lekë, sa i takon përdorimit të kësaj shume, nuk është i saktë. Nga aktet e administruara, konstatohet se më datë 08.07.2011, është xhiruar shuma prej 4.000.000 lekësh nga huadhënësi G.S. në llogarinë rrjedhëse të huamarrësit Q.K. dhe, pas një muaji, më datë 09.08.2011, huamarrësi investoi në bono thesari me maturim njëvjeçar shumën 4.000.000 lekë. Këto veprime bien ndesh me qëllimin e deklaruar nga subjekti në Komision, sipas të cilit huaja është marrë për të blerë një njësi shërbimi nga z. I.Rr. (kunati i babait të subjektit të rivlerësimit).
- ii) Nuk është hetuar plotësisht nga Komisioni se kur i ka kaluar pagesa e parë e huas prej 3.000.000 lekësh babait të subjektit. Në kontratën e huas përcaktohet se nga vlera 7.000.000, është dhënë paraprakisht në *cash* vlera 3.000.000 lekë, pra para korrikut 2011. Ndërkohë, nga përgjigjet e subjektit rreth derdhjes në llogarinë bankare të të atit, më datë 15.11.2011, të shumës 3.300.000 lekë (derdhur nga ai vetë), me përshkrim “të ardhura nga biznesi”, subjekti në pyetësinë e datës 22.02.2018 të Komisionit, shprehet se kjo shumë “është pjesë nga huaja e marrë prej 7.000.000 lekësh, pra pjesa 3.000.000 lekë dhe pjesa tjetër prej 270.000 lekësh, është interesi i tërhequr më datë 23.08.2011 nga bonot e thesarit të Bankës së Shqipërisë”. Edhe në këtë rast, babai i subjektit ka investuar shumën 3.270.000 lekë në bono thesari, pranë Bankës “Raiffeisen”, më datë 23.12.2011, fakt i cili nuk korrespondon me qëllimin e deklaruar të huas.
- iii) Është kryer hetim nga Komisioni mbi mundësinë financiare të dhënies së huas nga shtetasi G.S., por ky hetim nuk është pasqyruar në vendim. Nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. {***} prot., datë 22.03.2018, është konfirmuar se shtetasi G.S. është ortak në disa shoqëri, por nuk rezulton të ketë shpërndarë dividend apo të ketë realizuar fitim deri në vitin 2011.

9.3. Për likuiditetet e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të nuk është bërë një hetim i plotë lidhur me vlerat e tyre, që kanë rezultuar ndër vite në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të.

i) Për periudhën 2003-2011, nuk janë hetuar gjendjet e likuiditeteve të subjektit të rivlerësimit, znj Nertina Kosova, dhe të familjarëve të saj/personave të lidhur, të gjendura në llogari bankare, konkretisht:

1. Në deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë për vitin (në vijim “DV”) 2003, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar likuiditete *cash* apo në llogari bankare. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, rezulton se në këtë vit, gjithsej likuiditete të pahetuara në emër të babait të subjektit janë në shumën 2.037.446 lekë.
2. Në DV 2004, subjekti ka deklaruar gjendje në bankë shumën 200.000 lekë, me 50% pjesë takuese. Nga verifikimi i llogarive bankare të kësaj periudhe, rezulton se likuiditete të pahetuara në fund të vitit 2004, janë gjithsej 2.737.552 lekë.
3. Në DV 2005, subjekti ka deklaruar gjendje në bankë 200.000 lekë, me 50% pjesë takuese, si edhe ka deklaruar gjendje në llogari, kredinë në shumën 5.000.000 lekë nga Banka “Raiffeisen”. Likuiditete të pahetuara në fund të vitit 2005, janë 2.775.401 lekë gjithsej.
4. Në DV 2006, subjekti ka deklaruar kursime nga paga 400.000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, likuiditete të pahetuara për vitin 2006, janë 1.803.791 lekë.
5. Në DV 2007, subjekti ka deklaruar kursime nga pagat 500.000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, likuiditete të pahetuara për vitin 2007, janë në shumën 1.544.648 lekë.
6. Në DV 2008, subjekti ka deklaruar kursime nga pagat 300.000 lekë. Likuiditete të pahetuara për vitin 2008, janë në shumën 1.544.648 lekë gjithsej.
7. Në DV 2009, subjekti ka deklaruar kursime nga pagat 400.000 lekë, të cilat gjenden në depozitën e subjektit pranë Bankës “Raiffeisen”. Likuiditete të pahetuara për vitin 2009, janë 2.342.811 lekë gjithsej.
8. Në DV 2010, subjekti ka deklaruar kursime nga pagat 500.000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar në dispozicion, likuiditete të pahetuara për vitin 2010, janë 2.933.603 lekë gjithsej.
9. Në DV 2011, subjekti ka deklaruar “Pakësim kursime *cash*, të mbartura deri në datë 31.12.2010, për blerje bono thesari, me afat deri në 29.03.2012”, shuma e deklaruar 800.000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar, likuiditete të pahetuara për vitin 2011, janë 9.097.566 lekë gjithsej.

ii) Komisioni nuk ka hetuar në lidhje me burimin e ligjshëm të likuiditeteve bankare, konkretisht për transfertën bankare në vlerën prej 22.350 USD, të kryer nga ana e vëllait të subjektit të rivlerësimit, më datë 06.04.2005.

9.4. Për çështje të tjera: Komisioni nuk ka hetuar mbi shkaqet e mosdeklarimit dhe mbi mundësitë financiare të babait të subjektit të rivlerësimit, si person i lidhur për të blerë automjetin. Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 23.04.2018, të Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim “DRShTRr”) {***}, babai i subjektit të rivlerësimit ka në pronësi mjetin me targë {***} dhe subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, ka pasur në pronësi mjetin me targë {***}, i cili ka dalë nga qarkullimi më datë 08.07.2010. Ky i fundit është përdorur dhe

poseduar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, gjatë periudhës që ajo ka pasur detyrimin për ta deklaruar dhe, sipas Komisionerit, rezultoi në blerje nga babai i subjektit në vlerën 880.000 lekë në vitin 2000, disponuar deri në vitin 2008, dhe vetë subjekti ka pasur policë sigurimi që ka mbuluar periudhat nga 26.04.2007 - 25.04.2008 dhe 26.04.2008 - 25.04.2009.

10. Përkundër sa parashtroi Komisioneri Publik në ankim, subjekti i rivlerësimit kërkoi lënien në fuqi të vendimit nr. 43, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duke parashtuar se ka vlerësim maksimal në kriterin e figurës dhe në kriterin e vlerësimit profesional, nuk ka denoncime ndaj saj dhe ende sot, pas 21 viteve punë si gjyqtare, ka vetëm një pasuri të paluajtshme në vlerën 6.000.000 lekë, ende të paregjistruar në emrin e saj, nga të cilat 5/6 janë financuar me kredi dhe vetëm 1/6 është financuar nga kursimet e saj, duke i mbetur ende pa shlyer vlera 2.864.332,07 lekë.
11. Gjatë gjykimit në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, paraqiti një sërë aktesh dhe dokumentesh⁵ për të vërtetuar prapësimet dhe kundërgargumentet e saj ndaj ankimit të Komisionit Publik dhe, në funksion të marrjes së provave, kërkoi nga trupi gjykues i Kolegjit çeljen e hetimit. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se, pasi të vlerësohen të gjitha argumentet dhe provat shpresore të depozituara prej asaj vetë, referuar nenit D të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, do të rezultojë se prej saj janë deklaruar pasuritë që ajo disponon dhe ligjshmëria e burimit të tyre. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimit parashtroi sa vijon.

11.1. Lidhur me pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 120 m², në rr. “{*}”, subjekti i rivlerësimit parashtroi se:**

Të ardhurat e saj dhe të familjes kanë qenë të ligjshme dhe të mjaftueshme për të mundësuar kursimin e shumës prej 1.000.000 lekësh, që plotësoi çmimin e blerjes së apartamentit. Nga ana e Komisionerit Publik nuk është konsideruar përfundimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të kursente deri në vlerën 2.400.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit më tej parashtroi se shuma prej 1.000.000 lekësh ose prej 1.500.000 lekësh është kthimi i kontributeve të saj në familje dhe rrjedh nga kursimet e pagave të saj të ruajtura nga prindërit dhe të konsideruara saktësisht si të tilla edhe nga Komisioni. Lidhur me këto prapësime, subjekti i rivlerësimit paraqiti aktet e renditura si më poshtë:

1. vërtetim për përfitim burse me rezultate nr. {***} prot., datë 26.04.2019, nga Universiteti i {***} “{***}” për z. K.K.;
2. vërtetim nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit nr. {***} prot., datë 25.10.2016, për z. K.K.;
3. vërtetim i vitit 2018 nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (në vijim “ZVRPP”) {***};
4. vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (në vijim “ISSh”) {***} nr. {***}, datë 18.10.2016;
5. vërtetim i ZVRPP {***}, datë 23.04.2019, për z. K.K.;
6. vërtetim për pagën nga Policia e Ndërtimit {***} për z. K.K.;
7. vërtetim nga Bashkia {***} nr. {***} prot., datë 25.10.2016, për z. K.K.;
8. vërtetim page nga Policia e Ndërtimit {***} për z. K.K.;

⁵ Në seancën e datës 12.06.2019, paraqiti 61 dokumente provuese; në seancën e datës 03.07.2019, paraqiti 8 dokumente provuese dhe në seancën e datës 19.07.2019 paraqiti 2 dokumente provuese.

9. vërtetim nga ISSh për B.K. nr. {***} prot., datë 06.07.2018;
10. vërtetim nga Bashkia {***}, datë 30.04.2019, për Q.K.;
11. vërtetim nga Universiteti i Studimeve i {***}, Fakulteti i Drejtësisë, datë 05.07.1999, për Nertina Kosova, e noterizuar, e përkthyer dhe e legalizuar me vulë apostile;
12. kërkesë e znj. Ch. G.O. drejtuar Institutit Juridik “{***}”, datë 08.03.1999;
13. librezë depozite kursimesh pranë “Banca Nazionale del Lavoro”, në {***}, nr. {***}, në emër të znj. Nertina Kosova, periudhë veprimesh 23.02.1999 – 22.07.1999, e noterizuar, e përkthyer dhe e legalizuar me vulë apostile.

11.2. Për transfertën bankare të personit të lidhur, vëllait të subjektit të rivlerësimit, në vlerën 22.350 USD, si dhe në lidhje me burimin e krijimit të kësaj shume

Transferta e kryer nga vëllai, z. K.K., më datë 06.04.2005, drejt një llogarie jashtë vendit – marrëse shoqëria “{***}” – është realizuar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK, pranë së cilës vëllai i subjektit në kohën në fjalë ka qenë i punësuar. Shuma e transferuar nuk i përket vëllait. Më tej, subjekti parashtroi se drejt së njëjtës llogari janë transferuar shuma parash përpara dhe pas datës në fjalë. Sipas saj, ky ishte një veprim bankar/transaksion i kryer për llogari të shoqërisë, ashtu si edhe çdo veprim tjetër gjatë kohës kur ai ka vepruar si përfaqësues i shoqërisë. Transfertat kanë shkuar drejt së njëjtës llogari të shoqërisë “{***}”. Në lidhje me këtë parashtrim, subjekti i rivlerësimit depozitoi gjithsej 38 dokumente, të tilla si: akte, deklarata noteriale, urdhër transfertash bankare, mandatpagesa, urdhër derdhjeje, me të cilat kërkoi të provonte se vëllai nuk ka pasur marrëdhënie të drejtpërdrejtë me shoqërinë “{***}”, përveçse për llogari të punëmarrësit [shoqërisë “{***}” ShPK]. Lidhur me këto prapësime, subjekti i rivlerësimit paraqiti aktet e renditura si më poshtë:

1. kërkesë nga z. K.K. dhe kthim përgjigjeje nga z. N.B. (2 fletë);
2. kontratë pune e datës 23.01.2003, autorizim i datës 27.01.2003 dhe fotokopje e pasaportës së noterizuar;
3. urdhër transferte nga Banka “Societe Generale Albania” (ish-Banka Popullore) – nxjerrje llogarie nga Banka “Societe Generale Albania” (ish-Banka Popullore) për të provuar faktin e transferimit të një shume prej 22.350 USD më datë 06.04.2005 drejt shoqërisë “{***}”, në llogarinë me IBAN {***}, aty ku janë transferuar shumat 342.550 USD dhe 201.240 USD nga shoqëria “{***}” ShPK drejt shoqërisë “{***}”;
4. nxjerrje llogarie nga Banka OTP Albania (ish-Banka Popullore) – nxjerrje llogarie nga Banka “Societe Generale Albania” (ish-Banka Popullore) për të provuar faktin e transferimit të një shume prej 342.550 USD, më datë 03.02.2005, nga llogaria e shoqërisë “{***}” ShPK drejt llogarisë së shoqërisë “{***}”, me IBAN {***}, aty ku është transferuar shuma 22.350 USD nga z. K.K. Gjithashtu, në këtë nxjerrje llogarie nga Banka “Societe Generale Albania” (ish-Banka Popullore) provohet fakti i transferimit të një shume prej 201.240 USD, më datë 18.02.2005, nga llogaria e shoqërisë “{***}” ShPK drejt llogarisë së shoqërisë “{***}”, me IBAN {***}, aty ku është transferuar shuma 22.350 USD nga z. K.K.;
5. nxjerrje llogarie nga Banka “Raiffeisen”, datë 24.04.2019 – nxjerrje llogarie nga Banka “Raiffeisen” për të provuar faktin e transferimit të një shume prej 375.203 USD në datën 31.07.2006 nga llogaria e shoqërisë “{***}” ShPK drejt llogarisë së shoqërisë “{***}”, me IBAN {***}, aty ku është transferuar shuma 22.350 USD nga z. K.K.. Transferta është kryer pas emërimit të z. K.K. në një detyrë tjetër. Marrëdhënia tregtare “{***}” ShPK – “{***}” vazhdon;

6. urdhër transferte nga ish-Banka Popullore, datë 26.04.2019, për të provuar faktin e transferimit të një shume prej 342.550 USD në datën 03.02.2005 nga llogaria e shoqërisë “{***}” ShPK drejt llogarisë së shoqërisë “{***}”, me IBAN {***}, aty ku është transferuar shuma 22.350 USD nga z. K.K.;
7. kontratë tregtare e vitit 2005 e përkthyer, ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe shoqërisë “{***}”, për të provuar faktin e ekzistencës së marrëdhënies tregtare ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe shoqërisë “{***}”;
8. kontratë tregtare e vitit 2006 e përkthyer, ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe shoqërisë “{***}”, për të provuar faktin e ekzistencës së marrëdhënies tregtare ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe shoqërisë “{***}”;
9. kontratë tregtare, datë 02.02.2005, e përkthyer, ndërmjet shoqërive “{***}” ShPK dhe “{***}”, për të provuar faktin e ekzistencës së marrëdhënies tregtare ndërmjet tyre;
10. vendim nr. {***} akti, datë 03.10.2000, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor “{***}”, për regjistrimin si person juridik të shoqërisë “{***}” ShPK;
11. a) deklaratë doganore; b) mandatpagese – prova shkresore të datës 27.05.2005, për të provuar faktin e zhdoganimit të një sasive metalesh nga shoqëria “{***}”, importuar nga shoqëria “{***}” ShPK;
12. a) deklaram i detajuar doganor, viti 2006 (deklarata doganore të printuara nga sistemi “Asycuda” i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave për të provuar faktin e zhdoganimit të një sasive metalesh nga shoqëria “{***}”, importuar në Shqipëri nga shoqëria “{***}” ShPK); b) deklaram i detajuar doganor, viti 2007 (deklarata doganore të printuara nga sistemi “Asycuda” i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për të provuar faktin e zhdoganimit të një sasive metalesh nga shoqëria “{***}”, importuar në Shqipëri nga shoqëria “{***}” ShPK);
13. a) mandatpagese i datës 09.11.2004, me numër {***}, pranë Bankës Tirana; b) deklaratë doganore, datë 09.11.2004; c) mandatarkëtimi – prova shkresore të datës 09.11.2004 për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK një garanci doganore;
14. a) faturë tatimore shitjeje e datës 05.09.2005, me nr. serie {***}, me nr. fature {***}, e lëshuar nga “{***}” Tiranë – provë shkresore e datës 05.09.2005, për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK; b) dëshmi për sigurimin e mallrave gjatë transportit, me nr. serie {***}, e lëshuar nga {***} ShA Tiranë – provë shkresore që tregon policën e sigurimit që është paguar nga z. K.K. për shoqërinë “{***}” ShPK;
15. a) mandatpagesë e datës 27.04.2004, me numër {***}, pranë Bankës Tirana për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK; b) deklaratë doganore e datës 27.04.2004; c) fletëhyrje e datës 27.04.2004;
16. a) mandatpagesë e datës 02.04.2004, me numër {***}, pranë Bankës Tirana, për deklaratën doganore {***}, për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK; b) deklaratë doganore e datës 02.04.2004; c) fletëhyrje, datë 02.04.2004, për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
17. a) mandat - urdhër derdhjeje i datës 24.07.2004, pranë Bankës së Kursimeve me urdhërues shoqëria “{***}” ShPK, përfituesi Dega e Doganës {***}, për të provuar faktin që z. K.K. ka kryer veprim dhe ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK; b) deklaratë doganore e datës 24.07.2004; c) fletëhyrje e datës 24.07.2004;
18. a) mandat - urdhër derdhjeje i datës 07.08.2004, pranë Bankës “Raiffeisen”, për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK drejt përfituesit, Dogana

- {***}; b) deklaratë doganore e datës 07.08.2004; c) mandatarkëtimi; ç) fletëhyrje e datës 07.08.2004;
19. a) mandatpagesë e datës 27.08.2004, me numër {***}, pranë Bankës Tirana, nënshkruar nga z. K.K.; b) deklaratë doganore e datës 27.08.2004; c) mandatarkëtimi i datës 27.08.2004, për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
 20. faturë tatimore shitjeje e datës 30.09.2004, me nr. serie “{***}”, me nr. fature “{***}”, e lëshuar nga {***} (provë shkresore për të vërtetuar që z. K.K. ka nënshkruar faturë blerjeje kancelarie, për llogari të shoqërisë {***} ShPK);
 21. a) mandatpagesë e datës 17.09.2004, me numër {***}, pranë Bankës Tirana, për të provuar faktin që z. K.K. ka kryer veprim për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK; b) deklaratë doganore e datës 17.09.2004; c) fletëhyrje e datës 17.09.2004, për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
 22. a) mandat - urdhër derdhjeje i datës 09.10.2004, pranë Bankës së Kursimeve, nga shoqëria “{***}” ShPK, me përfitues Dogana {***}, ku ka nënshkruar z. K.K.; b) deklaratë doganore e datës 09.10.2004; c) mandatarkëtimi i datës 09.10.2004, për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
 23. a) mandatpagesë e datës 25.10.2004, me numër {***}, pranë Bankës Tirana, me përshkrimin: “Firma {***} - TVSh”, ku ka nënshkruar z. K.K.; b) deklaratë doganore e datës 25.10.2004; c) mandatarkëtimi i datës 25.10.2004, për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
 24. a) mandat - urdhër derdhjeje i datës 30.10.2004, pranë Bankës së Kursimeve/Banka “Raiffeisen”, me përfitues Dega e Doganës {***}, ku nënshkruet për veprimin e shoqërisë “{***}” ShPK, është z. K.K.; b) deklaratë doganore e datës 30.10.2004; c) mandatarkëtimi i datës 30.10.2004, për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
 25. a) mandatpagesë e datës 19.11.2004, me numër {***}, pranë Bankës Tirana, me nënshkruet z. K.K., për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK, me përfitues Dega e Doganës {***}; b) deklaratë doganore e datës 19.11.2004; c) mandatarkëtimi i datës 19.11.2004, për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
 26. a) mandatpagesë e datës 15.04.2004, me numër {***}, pranë Bankës Tirana, me nënshkruet z. K.K. për shoqërinë “{***}” ShPK; b) deklaratë doganore e datës 15.04.2005; c) faturë tatimore – mandatarkëtimi; ç) fletëhyrje e datës 15.04.2004, për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
 27. faturë tatimore shitjeje e datës 14.04.2005, me nr. serie {***}, me nr. fature {***}, e lëshuar nga “{***}” ShA, për të provuar që z. K.K. ka nënshkruar faturën e blerjes “llamarinë e zezë”, për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
 28. a) mandat - urdhër derdhjeje i datës 26.03.2005, me numër {***}, pranë Bankës “Raiffeisen”, me nënshkruet z. K.K.; b) deklaratë doganore; c) fletëhyrje; ç) “Proforma Invoice”, datë 23.03.2005; d) mandatarkëtimi i datës 26.03.2005, i doganës për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
 29. a) mandat - urdhër derdhjeje i datës 08.07.2005, me numër {***}, pranë Bankës “Raiffeisen” për faturën e nënshkruar nga z. K.K. për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK; b) deklaratë doganore e datës 08.07.2005; c) mandatarkëtimi i datës 08.07.2005, i doganës;
 30. a) mandatpagesë e datës 18.07.2005, me {***}, pranë Bankës Tirana, me përshkrimin “{***}, TVSh {***}”, ku nënshkruet është z. K.K., në rubrikën “klienti”; b) deklaratë doganore me

- numër {***}, datë 18.07.2005; c) mandatarkëtimi i datës 18.07.2005, i doganës, për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
31. a) mandatpagesë e datës 27.07.2005, me referencë {***}, pranë Bankës “Raiffeisen”, ku si nënshkrues është z. K.K., për veprim të shoqërisë “{***}” ShPK; b) deklaratë doganore me numër {***}, data 27.07.2005; c) mandatarkëtimi i datës 27.07.2005, i doganës; ç) mandat i doganës, i datës 27.07.2005, për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
 32. a) mandatpagesë e datës 26.09.2005, me numër {***}, pranë Bankës Tirana; b) mandatpagesë e datës 26.09.2005, me numër {***}, pranë Bankës Tirana, me nënshkrues z. K.K., për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK; c) deklaratë doganore, data 26.09.2005; d) mandatarkëtimi, datës 26.09.2005, i doganës për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
 33. a) mandatpagesë e datës 14.07.2004, me numër {***}, pranë Bankës Tirana nga shoqëria “{***}” ShPK drejt “Dega e Doganës”, në të cilin ka nënshkruar për këtë veprim bankar z. K.K.; b) deklaratë doganore, data 14.07.2004; c) fletëhyrje e datës 14.07.2004, për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
 34. a) mandatpagesë e datës 06.07.2004, me numër {***}, pranë Bankës Tirana, ku z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK; b) deklaratë doganore, datë 06.07.2004; c) fletëhyrje të datës 06.07.2004, që provojnë faktin se z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
 35. faturë tatimore shitjeje, me nr. serie {***}, datë 30.09.2004, për të provuar që z. K.K. ka nënshkruar faturë blerjeje kancelarie për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
 36. a) mandatpagesë e datës 09.07.2004, me numër {***}, pranë Bankës Tirana, ku z. K.K. ka nënshkruar për llogari të “{***}” ShPK, me përfitues Dega e Doganës {***}; b) deklaratë doganore, data 09.07.2004; c) fletëhyrje për të provuar faktin që z. K.K. ka nënshkruar për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK;
 37. deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.04.2019, e shtetasit N.B., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, në të cilën deklarohet se transaksioni në vlerën 22.350 USD, nga vëllai i subjektit të rivlerësimit është kryer për llogari të kësaj shoqërie;
 38. deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.05.2019, e shtetasit K.K., në të cilën ai deklarohet se transaksioni në vlerën 22.350 USD është kryer për llogari të shoqërisë “{***}” ShPK.

11.3. Për huan e marrë nga babai i subjektit të rivlerësimit Q.K. ndaj shtetasit G.S.

11.3.1. Subjekti parashtror se në vlerësimin e saj, në zbatim të ligjit, i ati nuk mund të cilësohet as person tjetër i lidhur, pasi ajo nuk ka krijuar marrëdhënie dhurimi apo huaje me të. Gjatë gjykimit, subjekti i rivlerësimit shtoi se pretendimet e Komisionerit që prona ka qenë e bllokuar nga banka në kohën kur i ati shprehet se do blinte njësinë, nuk qëndrojnë. Vetëm një pjesë e truallit ishte nën barrë vullnetare hipotekore të Bankës “Alpha”, sepse trualli ishte nën regjimin e të drejtës së kalimit për banorët e katit të dytë. Për të mbështetur këtë parashtrim, subjekti i rivlerësimit paraqiti 5 (pesë) dokumente, përfshirë vërtetime dhe harta hipotekore, si dhe shkresë nga ZVRPP {***}, si më poshtë:

1. vërtetim dhe hartë nga Dokumentet Hipotekore për pasurinë e llojit “Njësi”, me numër pasurie {***}, me sipërfaqe 62 (gjashtëdhjetë e dy) metra, ku në seksionin barrë mbi pasurinë nuk ka asnjë shënim, pra tregon që nuk është bllokuar në favor të bankës. Aktualisht është e regjistruar në emër të trashëgimtarëve të z. I.Rr.;

2. kthim përgjigjeje nga ZVRPP {***} nr. {***}, nr. aplikimi datë 26.04.2019, sipas së cilës provohet fakti që njësia nuk ka qenë asnjëherë e bllokuar për bankën;
3. vërtetim dhe hartë nga Dokumentet Hipotekor për pasurinë e llojit “Truall”, me numër pasurie {***}, me sipërfaqe 68,5 (gjashtëdhjetë e tetë presje pesë) metra, ku në seksionin barrë mbi pasurinë shënohet: “Vënë në hipotekë në favor të Alpha Bank”, me inskript {***}, datë 13.09.2007. Aktualisht është e regjistruar në emër të trashëgimtarëve të z. I.Rr.;
4. vërtetim dhe hartë nga Dokumentet Hipotekore për pasurinë e llojit “Apartament”, me numër pasurie {***}, me sipërfaqe 182,5 (njëqind e tetëdhjetë e dy presje pesë) metra, ku në seksionin barrë mbi pasurinë shënohet: “Vënë në hipotekë në favor të Alpha Bank”, me inskript {***}, datë 13.09.2007. Aktualisht është e regjistruar në emër të trashëgimtarëve të z. I.Rr.;
5. kontratë hipotekimi me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 12.09.2007, për pasurinë e llojit “Apartament”, me numër pasurie {***}, me sipërfaqe 182,5 (njëqind e tetëdhjetë e dy presje pesë) metra dhe për pasurinë e llojit “Truall”, me numër pasurie {***}, me sipërfaqe 68,5 (gjashtëdhjetë e tetë presje pesë) metra.

11.3.2. Në lidhje me kohën e kalimit të shumës prej 7.000.000 (shtatë milionë) lekësh nga huadhënësi, z. S., te babai i saj, siç vërtetohet nga transferata bankare në Bankën “Raiffeisen”, 4.000.000 lekë kanë kaluar në datën 08.07.2011, ndërsa shuma e dhënë paraprakisht sipas përcaktimit kontraktor, është dhënë në datën 08.07.2011. Për të vërtetuar këtë fakt, pra, datën e saktë të dhënies së kësaj shume, subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kososva, paraqiti deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.04.2019, të z. G.S., i cili deklaroi se këtë shumë ia ka kaluar babait të saj në datën 08.07.2011, pra po atë ditë të lidhjes së kontratës. Subjekti i rivlerësimit parashtrroi se hetimi i kësaj marrëdhënieje kontraktuale është në tejkallim dhe kundërshtim me ligjin nr. 84/2016, pasi ajo është shkëputur nga trangu familjar që prej datës 27.05.2011, kurse huaja është dhënë më datë 08.07.2011. Sipas subjektit, bazuar në nenin 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, babai nuk është person tjetër i lidhur dhe shuma e marrë hua nga babai nuk ka shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie të luajtshme apo të luajtshme në emrin e saj dhe se ajo nuk ka asnjë marrëdhënie dhurimi, huaje apo interesi pasuror në këtë periudhë.

Gjithsesi, sipas subjektit të rivlerësimit, referuar dokumentacionit zyrtar të vënë në dispozicion Komisionit gjatë hetimit administrativ, është provuar se z. S. është bashkëpronar i një godine shumëkatëshe të ndodhur në {***}, sipas lejes së ndërtimit⁶ të vitit 2007. Në këtë leje ndërtimi, z. S. paraqitet si individ investitor së bashku me një individ tjetër, jo si persona juridikë. Bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji mund të hetonte për aftësinë huadhënëse të z. S. vetëm nëse huaja do i ishte dhënë vetë subjektit ose personave të lidhur me të. Për këto arsye, hetimi dhe kontrolli i veprimeve të të atit në lidhje me atë hua, subjekti vlerësoi se janë në tejkallim dhe në kundërshtim me ligjin, pasi janë veprime që nuk lidhen me vetë subjektin. Hetimi administrativ i kryer në Komision përjashtoi mundësinë e konfliktit të interesit mes subjektit dhe këtij individi. Në argumentin e mjaftueshmërisë financiare të z. S., subjekti i rivlerësimit paraqiti disa nga kontratat e porosisë të lidhura ndërmjet individit/investitor G.S. dhe porositësve të ndryshëm deri në atë moment, për periudhën 31.03.2008 – 06.01.2011, si më poshtë:

1. kontratë porosie nr. {***} rep., {***} kol., datë 31.03.2008; kontratë porosie nr. {***} rep., {***} kol., datë 09.06.2008; kontratë porosie nr. {***} rep., {***} kol., datë 04.08.2008; kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.09.2008; kontratë porosie nr., {***}

⁶ Nr. {***}, datë 08.10.2007, e ndryshuar me vendimin nr. {***}, datë 30.05.2008.

- rep., nr. {***} kol., datë 11.11.2008; kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.11.2008; kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.11.2008; kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.12.2008;
2. kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.01.2009; kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.01.2009; kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.01.2009; kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.01.2009; kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.08.2009; kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.08.2009;
 3. kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.01.2010; kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.02.2010; kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.03.2010; kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.07.2010; kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.08.2010; kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.09.2010; kontratë porosie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.01.2011.

Në lidhje me argumentin e ligjshmërisë së burimit, subjekti paraqiti vërtetim nga ZVRPP {***}, datë 06.05.2019.

11.4. Për likuiditetet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të në periudhën kohore që përfshin vitet 2003-2011, nuk është bërë hetim i plotë ndaj këtyre vlerave të likuiditeteve, që kanë rezultuar ndër vite në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të.

Subjekti i rivlerësimit parashtrroi se në dosjen e krijuar pranë Komisionit gjenden akte të lëshuara nga bankat e nivelit të dytë dhe nga këto nxjerrje llogarie rezulton se likuiditetet përbëhen nga e njëjta shumë e lëvizur nga banka, por në kohë të ndryshme, në varësi të përfitimit të interesave bankarë më të mirë dhe vërtetohet se burimi i krijimit të depozitave vjen nga kursimet me burime të ligjshme.

11.5. Për sa i përket mosdeklarimit nga ana e subjektit të një automjeti dhe mundësisë së babait të subjektit për të investuar

Në lidhje me hetimin që duhet të kishte kryer nga Komisioni për sa i përket mosdeklarimit të automjetit, subjekti i rivlerësimit parashtrroi se ky konstatim është i gabuar dhe se subjekti nuk ka apo nuk ka pasur automjet dhe as ka drejtuar ndonjë automjet, nuk përdor apo drejton ndonjë mjet. Subjekti solli dokumente të tjera që vërtetojnë se emri i saj nuk paraqitet as si mbajtëse e policës së sigurimit apo si pronare. Megjithëse nuk ka qenë detyrim i saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, solli një sërë dokumentesh për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij mjeti. Për të provuar argumentet e saj në lidhje me këtë shkak ankimi, subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, paraqiti aktet shkresore të renditura si më poshtë:

1. kërkesë drejtuar Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, datë 17.01.2019, nga subjekti i rivlerësimit;
2. kthim përgjigjeje nga AMF drejtuar subjektit të rivlerësimit, për dijeni Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me lëndë: “Konfirmim për mbulimin me sigurim”, me nr. {***} prot., datë 31.01.2019;
3. kthim përgjigjeje nga SIGAL drejtuar subjektit të rivlerësimit, nr. {***} prot., datë 16.01.2019.

Gjithashtu, për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave për blerjen nga babai i saj të automjetit furgon në datën 31.01.2000, subjekti i rivlerësimit paraqiti:

1. akt-marrëveshje për premtim shitblerje toke bujqësore, nr. {***} regj., datë 15.06.1999, që provon faktin se z. Q.K. së bashku me të vëllanë, z. S.K., kanë marrë më 15.06.1999, nga shtetasi B.I, secili shumën prej 850.000 (tetëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh për premtim shitje të pasurisë të llojit “tokë bujqësore”;
2. vërtetime të Këshillit të Rrethit {***}, datë 14.06.1999, në emër të z. S. e z. Q.K.;
3. akt i marrjes së tokës në pronësi në emër të z. S.K. e z. Q.K.;
4. kërkesë Këshillit të Qarkut, datë 23.05.2016;
5. shkresë nr. {***} prot., datë 30.05.2016, e Këshillit të Qarkut {***};
6. autorizim i datës 06.05.1993, i Këshillit të Rrethit {***};
7. relacion dhe kërkesë, datë 13.07.1993.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se nga Komisioni nuk është hetuar nëse vëllai i subjektit të rivlerësimit ka në pronësi apo përdorim mjete, subjekti i rivlerësimit paraqiti në seancën e datës 12.06.2019, vërtetim nga DPSHTRR, Drejtoria Rajonale {***}, datë 25.10.2016, sipas të cilit z. K.K. nuk ka të regjistruar mjete në pronësi.

12. Në seancën gjyqësore të zhvilluar në Kolegj, më datë 03.07.2019, subjekti i rivlerësimit paraqiti akte të reja në mbështetje të përgjigjeve të saj ndaj pyetjeve të parashtruara nga relatori i çështjes, të cilat, me vendim të ndërmjetëm të trupit gjykues të Kolegjit, u morën në cilësinë e provës dhe janë të renditura si më poshtë:
 1. kopje e vizës italiane të studimeve, lëshuar subjektit të rivlerësimit, për periudhën 12.02.1999 deri më 25.08.1999;
 2. konfirmim nr. {***} prot., datë 26.06.2019, i Bankës OTP, Dega Tiranë;
 3. vërtetim nr. {***} prot., datë 28.06.2019, i Bankës OPT, Dega Tiranë;
 4. kërkesë e datës 30.04.2019, e subjektit të rivlerësimit drejtuar Ambasadës Italiane dhe Institutit {***};
 5. komunikime me *e-mail* drejtuar Ambasadës Italiane etj.;
 6. shënim i Zyrës {***}, datë 02.05.2019, *e-mail*-e drejtuar stafit të arkivit të Universitetit të {***};
 7. kërkesë e subjektit të rivlerësimit drejtuar Bankës “Raiffeisen”, e datës 27.06.2019 dhe kthim përgjigjeje e Bankës “Raiffeisen”, subjektit të rivlerësimit, me shkresën nr. {***} prot., datë 28.06.2019;
 8. shkresë nr. {***} prot., datë 27.06.2019, e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve {***};
 9. vërtetim i datës 26.06.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {***}.
13. Në seancën gjyqësore të zhvilluar në Kolegj, më datë 19.07.2019, subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, paraqiti akte të reja në mbështetje të shpjegimeve të saj mbi analizën financiare të Kolegjit për periudhën 1995-2006, të renditura si më poshtë:
 1. deklaratën noteriale të R.V. E., sipas së cilës subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, ka qenë e ftuar nga A. dhe R.E. në periudhën 24.12.2004 – 03.01.2005 dhe 24.12.2006 – 03.01.2007 dhe se shpenzimet e udhëtimit kanë qenë të mbuluara, përfshirë edhe biletën e udhëtimit për periudhën e parë, të legalizuar me vulë apostile;
 2. programin e aktivitetit të periudhës 02.10.2005 – 06.10.2005, të organizuar në kuadër të “Projektit Cards 2003”/“Regional Round Table”, të zhvilluar në Kroaci, të shoqëruar me pagesën e dietave dhe shpenzimet personale në hotel.
14. Gjatë gjykimit të çështjes në Kolegj, Komisioneri Publik në shqyrtim të dokumenteve dhe akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës, parashtrroi sa vijon:

14.1. Në seancën gjyqësore të datës 21.06.2019, Komisioneri Publik, në referim të provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancën gjyqësore të datës 12.06.2019, vlerësoi se ato (provat) janë të mjaftueshme për të konsideruar të plotë hetimin lidhur me shkaqet e ankimit që kanë të bëjnë me:

- i. nevojën për përcaktimin e drejtë të gjendjes së fakteve që kanë lidhje me kontrollin dhe ligjshmërinë lidhur me lëvizjet bankare të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. K. K.;
- ii. nevojat për hetim të kërkuar në funksion të verifikimit të kohës së marrjes së diferencës së shumës *cash*, si dhe përcaktimit nëse huaja e marrë nga babai i subjektit, z. Q.K., ndaj shtetasit z. G.S.⁷ do të trajtohet ose jo si e marrë nga personi tjetër i lidhur, në kuptim të cilësimit që i jep personit të lidhur ligji nr. 84/2016;
- iii. ekzistencën e së njëjtës shumë që ka qarkulluar në sistemin bankar, në banka të ndryshme për periudha të ndryshme kohore (referuar likuiditeteve të padeklaruara të subjektit të rivlerësimit dhe personave të tjerë të lidhur me të⁸), duke nënvizuar se pasqyrimi i shumave në ankim, në vlerën e tyre vit pas viti, nuk ka nënkuptuar ekzistencën e një shume kumulative;
- iv. pronësinë e automjeteve të padeklaruara nga ana e subjektit të rivlerësimit (referuar çështje të tjera), përfshirë edhe kërkesën për hetim nëse vëllai i subjektit ka në pronësi apo përdorim mjete.

Në përfundim të parashtrimeve, Komisioneri Publik i kërkoi trupit gjykues të Kolegjit:

1. administrimin e provave të paraqitura nga ana e subjektit të rivlerësimit në seancën e datës 12.06.2019, në kuadër të hetimit në Kolegj të shkaqeve të ankimit;
2. kualifikimin si person tjetër i lidhur të z. Q.K., në cilësinë e tij si kryefamiljar i familjes, sipas gjendjes familjare të subjektit të rivlerësimit, të deklaruar ndër vite nga vetë subjekti dhe të vërtetuar nga aktet e gjendjes civile; dhe
- 2.1 analizimin e burimeve të ligjshme për krijimin e të ardhurave të ligjshme, përfshirë të ardhurat e subjektit, të kryefamiljarit, z. Q.K., për periudhën 1998 - shtator 2006, për verifikimin e burimit dhe ligjshmërisë së të ardhurave në vlerën prej 1.000.000 lekësh.

14.2. Në seancën gjyqësore të datës 19.07.2019, Komisioneri Publik, referuar analizës financiare të Kolegjit për periudhën gusht 1995 - 04.09.2006, konsideroi të mjaftueshme rezultatet e dy varianteve të analizës financiare: “Varianti I” – shpenzimet e jetesës të përllogaritura me 66% të të ardhurave familjare deri më datë 31.12.2002, ndërsa pas periudhës 1.1.2003 e në vijim të bazuara në përllogaritjet e kryera nga Komisioni; dhe “Varianti II” – shpenzimet e jetesës të përllogaritura sipas metodologjisë referuar ILDKPKI-së⁹ nga INSTAT ndër vite, për të dalë në përfundime për kërkimet e tij, duke ruajtur të njëjtin standard vlerësimi.

14.3. Në parashtrimet përfundimtare të paraqitura në seancën gjyqësore të datës 22.07.2019, Komisioneri Publik vlerësoi se të gjitha shkaqet e ankimit të tij, në referencë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, gjetën përgjigje nga rreth 70 prova të reja, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë shqyrtimit gjyqësor¹⁰ dhe, për rrjedhojë, e bën të justifikuar vendimmarrjen e këtij trupi gjykues për lënien në fuqi të vendimit nr. 43/2018 të Komisionit, por me një tjetër arsyetim.

⁷ Trajtuar në paragrafin A.2 të ankimit.

⁸ Trajtuar në paragrafin A.3 të ankimit.

⁹ Referuar shkresës nr. {***}prot., datë 04.03.2019.

¹⁰ Subjekti paraqiti dhe u administruan: (i) 61 akte në seancën e datës 12.6.2019; (ii) 8 akte në seancën e datës 3.7.2019 dhe (iii) 2 akte lidhur me shpenzimet e subjektit për udhëtimet jashtë vendit, në seancën e datës 19.7.2019.

Në përfundim, për secilin shkak ankimi, Komisioneri Publik parashtroi sa vijon:

1. *Lidhur me verifikimin e burimit të ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme në vlerën 1.000.000 lekë, të cilat kanë shërbyer në krijimin e pasurisë së deklaruar nga subjekti, apartament banimi (rr. “{***}”, Tiranë), analiza financiare e kryer nga Kolegji bëri të mundur verifikimin e origjinës dhe të burimit të ligjshëm të të ardhurave të ligjshme prej 1.000.000 lekësh, të përdorura nga ana e subjektit sipas kontratës së sipërmarrjes së shtatorit 2006, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, burim i cili, sipas kësaj analize, identifikohet qartësisht në të ardhurat e ligjshme të familjes Kosova, administruar nga personi tjetër i lidhur, babai i subjektit, z. Q.K.. Komisioneri Publik nënvizon faktin se në këtë analizë financiare, një pjesë e bursës studentore që subjekti i rivlerësimit kishte përfituar në vitin 1999, nga MPJ e Republikës së Italisë, ishte përfshirë në zërin e të ardhurave të ligjshme.*
2. *Lidhur me nevojën për verifikimin e rrethanave faktike e juridike dhe lidhja e tyre me subjektin e rivlerësimit, për transfertën bankare të kryer nga i vëllai (burimi i ligjshëm), provat e administruara për këtë shkak ankimi, më së paku treguan se vëllai i subjektit të rivlerësimit ka vepruar si përfaqësues i interesit tregtar të shoqërisë “{***}” ShPK, pasi në to identifikohet si llogaria bankare dërguese, ajo pritëse, përfituese në Mbretërinë e Bashkuar dhe qëllimi i saj. Komisioneri Publik mbështeti pretendimin e subjektit të rivlerësimit se transfertat bankare e mësipërme nuk ndikon në vlerësimin e kriterit të pasurisë së rastit konkret.*
3. *Lidhur me huan e marrë nga babai i subjektit, z. Q.K., nga shtetasi G.S., aktet e administruara provojnë se nuk ka ndonjë indicie apo rrethanë faktike që të përfshijë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, subjektin e rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, në këtë marrëdhënie huaje, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së saj në raport me procesin e rivlerësimit.*
4. *Lidhur me likuiditetet e padeklaruara të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur/tjerë të lidhur me të, vërtetohet se likuiditetet e deklaruara dhe ato të gjendura në llogaritë bankare kanë si burim të vetëm të ardhurat e ligjshme nga paga e subjektit të rivlerësimit (burim i ligjshëm), bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9049/2003 dhe se subjekti gjendet në kushtet e deklaramit të pasaktë. Në vështrim të detyrimit ligjor që subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur/të tjerë të lidhur me të (pasuri e paluajtshme, e luajtshme, likuiditete), për sa kohë që në rastin konkret nuk ka rrethana apo fakte që të justifikojnë dyshime mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit, pasaktësitë në deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë të subjektit të rivlerësimit, nuk mund t’i jepet pesha dhe roli, e tillë sa, që në zbatim të dispozitave kushtetuese e atyre ligjore, të gjejë zbatim masa disiplinore.*
5. *Lidhur me çështje të tjera, ka rezultuar se Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim “AMF”) dhe kompania siguroese kanë pranuar se ka pasur një gabim material në prezantimin drejt të faktit dhe se për periudhat 26.04.2007 – 25.04.2009 rezulton i siguruar vetëm personi tjetër i lidhur, babai i subjektit të rivlerësimit dhe se sikundër rezultoi nga analiza financiare e Kolegjit, babai i subjektit të rivlerësimit, nën regjimin e ekonomisë së përbashkët familjare, ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti.*

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

15. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit Nertina Kosova, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

16. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016¹¹.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

17. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, ankimet nga Komisioneri Publik shqyrtohen në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me ankimin e Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 43, datë 18.07.2018, për subjektin e rivlerësimit Nertina Kosova, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në datat 12.06.2019, 21.06.2019, 26.06.2019, 03.07.2019, 12.07.2019, 19.07.2019, në prani të palëve.
18. Pasi dëgjoi shpjegimet e palëve lidhur me ankimin, në funksion të shqyrtimit të çështjes, me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi marrjen si prova të dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.
19. Bazuar në provat e marra gjatë gjykimit në Kolegji, si dhe në funksion të shqyrtimit të shkaqeve të ankimit mbi verifikimin e saktësisë së deklaramit dhe mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, parë kundrejt likuiditeteve të deklaruara, trupi gjykues vendosi të kryejë analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, për periudhën e rivlerësimit 2007-2016, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor. Analiza financiare iu paraqit subjektit të rivlerësimit dhe Komisionerit Publik, duke iu dhënë atyre mundësinë ta debatonin atë në seancat gjyqësore publike. Subjekti i rivlerësimit, në funksion të kësaj analize financiare, kërkoi marrjen e provave të tjera shkresore, të cilat, pasi u pranuan nga trupi gjykues, u debatuan prej palëve.

¹¹ Vendimi nr. 43, datë 18.07.2018, i Komisionit për rivlerësimin e subjektit, znj. Nertina Kosova, i është njoftuar Institucionit të Komisionerit Publik, i cili me shkresën nr. {***} prot., datë 24.09.2018, i ka përcjellë Komisionit ankimin e tij. Komisioni me vendimin nr. 43/1, datë 25.09.2018, ka vendosur pranimin e ankimit.

20. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi mori në cilësinë e provave shkresore aktet e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, së bashku me kundërshtimet e saj ndaj ankimit dhe ato në seancat në vijim, ia nënshtroi ato debatit gjyqësor lidhur me vlerën provuese.

B. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

21. *Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik mbi hetimin dhe administrimin e provave mbi verifikimin e burimit të ligjshëm për krijimin e të ardhurave të ligjshme në vlerën 1.000.000 lekë, të cilat kanë shërbyer në krijimin e pasurisë së deklaruar nga subjekti, apartament banimi, me sipërfaqe 120 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, krijuar në vitin 2006, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.09.2006, në vlerën 6.000.000 lekë, e paregjistruar në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, e banueshme në vitin 2008, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:*

21.1. Pasi kreu analizën financiare, referuar edhe përgjigjeve të pyetësorëve nr. 4 dhe nr. 5 dërguar nga subjekti, respektivisht më datë 12.06.2018 dhe 20.06.2018, Komisioni konstatoi se në vitin 2006 subjekti gjendej në pamjaftueshmëri financiare për të justifikuar shumën 1.847.164 lekë. Në këto kushte, duke mbetur aftësia kursyese nga kursimet e krijuara prej kontributit të saj dhe të mbajtura nga prindërit kryesisht në nivel deklarativ, aftësia paguese për këstin prej 1.000.000 lekësh për blerjen e apartamentit, si dhe për pjesën tjetër prej 847.164 lekësh, për të realizuar shpenzimet e tjera gjatë këtij viti, nuk provohej. Komisioni vendosi të kërkojë provueshmërinë shteruese me dokumentacion justifikues shtesë dhe më datë 04.07.2018, pasi mbylli hetimin kryesisht dhe vendosi dërgimin e rezultateve të hetimit subjektivit të rivlerësimit, për këtë konstatim, i kaloi subjektivit edhe barrën e provës. Nga dokumentacioni i sjellë nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, Komisioni konstatoi depozitë në emër të babait të subjektivit, z. Q.K., në shumën 1.900.000 lekë, pranë Bankës “Societe Generale Albania” në vitin 2006, nga e cila është kryer një transaksion bankar në datën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes (04.09.2006), në shumën 600.000 lekë.

21.2. Komisioni vlerësoi se depozita bankare dhe më tej edhe veprimet bankare për llogari të subjektivit të rivlerësimit pasqyrojnë marrëdhënien e posaçme familjare dhe kontributin e dhënë në blerjen e pasurisë. Veprimet bankare, vërtetimet e punësimeve të anëtarëve të familjes, përfshirë edhe subjektivin e rivlerësimit, deklarata noteriale e z. Kosova etj., vërtetojnë qartazi marrëdhënien e përbashkët familjare, mundësinë e krijimit të të ardhurave dhe njëkohësisht edhe administrimin e tyre nga babai i saj. Në analizë të provave të reja dhe të deklarimeve të subjektivit, Komisioni kreu analizën financiare duke rillogaritur të ardhurat e përfituara nga pagat e subjektivit në vitin 2006, shpenzimet për mobilim në këtë vit, në shumën 20.000 lekë, shpenzimet e udhëtimit të subjektivit të rivlerësimit, si dhe duke përfshirë edhe kursimet e realizuara nga kontributi i saj i administruar nga prindërit. Nga analiza financiare e kryer sërish nga Komisioni, rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e shumës 1.000.000 (një milion) lekë, si pjesë e investuar prej saj në blerjen e kësaj pasurie.¹²

21.2. Për këtë shkak ankimi, në zbatim edhe të orientimit të dhënë nga Kolegji [në vendimin (JR) nr. 7/2019], Komisioneri Publik vlerësoi se hetimi, analiza financiare dhe arsyetimi i Komisionit

¹² Shih faqet 9-10 të vendimit të Komisionit.

ishin jo të plotë dhe, për rrjedhojë, konkluzionet nuk ishin të bazuara në një interpretim të drejtë të ligjit nr. 84/2016. Sipas Komisionerit Publik, nevoja për kryerjen e një analize të re financiare nevojitet për vlerësimin e burimit të ligjshëm të këtyre të ardhurave të ligjshme, duke cilësuar babain e subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e tij si kryefamiljar i familjes Kosova, si person tjetër të lidhur, sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe gjendjes familjare të saj, vërtetuar nga aktet e gjendjes civile.

21.3. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në kërkesën e parashtruar në seancën gjyqësore të datës 21.06.2019, nga Komisioneri Publik dhe të evidentuar dukshëm në ankimin e tij se Komisioni ka kryer një analizë të mangët financiare gjatë hetimit administrativ¹³, me vendim të ndërmjetëm vendosi të kryejë një analizë financiare lidhur me mundësinë e babait të subjektit të rivlerësimit që, në cilësinë e kryefamiljarit ose të personit që ka administruar të ardhurat e familjes së subjektit të rivlerësimit gjatë kohës që subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e përbërjes familjare, për të krijuar kursime të mjaftueshme me të ardhura nga burime të ligjshme, në mënyrë që t'i jepte subjektit të rivlerësimit shumën 1.000.000 lekë në datën 04.09.2006 për blerjen e apartamentit.¹⁴

21.4. Në vijim, Njësia e Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit analizoi të ardhurat, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, duke përfshirë:

- a. *të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, znj. Nertina Kosova*, për periudhën gusht 1995 – 4.9.2006, të cilat sipas deklarimeve të saj janë dorëzuar në familje dhe janë administruar nga i ati në cilësinë e kryefamiljarit, së bashku me të ardhurat e tjera familjare. Analiza financiare është kryer për njësinë ekonomike familjare Kosova me katër persona, sipas kërkesës së Komisionerit Publik, përfshirë vetëm të ardhurat e ligjshme të familjes Kosova, në referencë të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
- b. *shpenzimet e identifikuar të kryera nga familja Kosova* për periudhën gusht 1995 – 4.9.2006, siç janë shpenzimet për blerje automjeti, pagesë kësti për shoqërinë “{***}” ShPK, shpenzime për qira dhe shpenzime për udhëtime jashtë shtetit, sipas të dhënave të sistemit TIMS;
- c. *kursime*, duke marrë në konsideratë gjendjen në llogaritë bankare dhe ndryshimet në to, në emër të subjektit, babait, nënës dhe vëllait.

Analiza financiare u krye nga Njësia e Shërbimit Ligjor pranë Kolegjit në tri variante, për zërin “shpenzime jetese”, si më poshtë:

- o *Varianti I* – shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur në masën 66% të të ardhurave familjare deri më 31.12.2002 dhe nga data 1.1.2003 e në vijim, janë sipas përlllogaritjeve të kryera nga Komisioni¹⁵;
- o *Varianti II* – shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas metodologjisë së përdorur nga ILDKPKI, bazuar në të dhënat e dërguara nga Instituti i Statistikave (në vijim “INSTAT”)¹⁶, si i vetmi institucion përgjegjës dhe i specializuar në Republikën e Shqipërisë për treguesit statistikorë të konsumit vjetor dhe mujor për familje dhe për frymë, ku për vitet 2000 dhe 2006,

¹³ Shih paragrafin 17.3, faqe 7 të ankimit - <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/10/10.Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-43-dat%C3%AB-18.7.2018-t%C3%AB-KPKp%C3%ABr-subjektin-e-rivler%C3%ABsimit-znj.-Nertina-Kosova.pdf>

¹⁴ Vendim i dhënë në seancën gjyqësore të datës 21.06.2019.

¹⁵ Komisioni shpenzimet për konsum mujor për frymë i ka përlllogaritur duke pjesëtuar vlerën e shpenzimeve për konsum të përlllogaritur në raportin e ILDKPKI-së për familjen Kosova prej 9.000.000 lekësh, me numrin e viteve nën analizë 2003-2016, pra 14 vite, pjesëtuar me numrin e anëtarëve të familjes (katër) dhe numrin e muajve të vitit (12 muaj).

¹⁶ Shih shkresën e ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 04.03.2019

të dhënat janë marrë nga Anketa e Buxhetit të Familjes, publikuar në faqen elektronike zyrtare të INSTAT¹⁷, ndërsa për vitet 2002-2005, sipas të dhënave të “Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës”, publikuar në faqen elektronike zyrtare të INSTAT¹⁸;

- o *Varianti III* – shpenzimet e jetesës janë përlogaritur në masën 66% të të ardhurave familjare deri më 31.12.2002 dhe nga data 01.01.2003 e në vijim, sipas të dhënave të “Shpenzimeve mujore për konsum sipas madhësisë së njësisë ekonomike familjare” (në vijim “NjEF”)¹⁹, të afektuar me të dhënat e “Shpenzimeve mujore për konsum sipas qarqeve”, publikuar nga INSTAT²⁰, afektuar me inflacionin e përlogaritur sipas Indeksit të Çmimeve të Konsumit (ndryshimin mesatar vjetor të çmimeve të shportës), të publikuar nga INSTAT²¹.

21.5. Në seancën gjyqësore të datës 19.07.2019, Komisioneri Publik u shpreh se rezultatet e dy varianteve të analizës (varianti I dhe II) i konsideron të mjaftueshme për të dalë në përfundime për kërkimet e tij, duke ruajtur të njëjtin standard vlerësimi. Në parashtrimet përfundimtare²², Komisioneri Publik nënvizoi faktin se provat e reja të administruara në këtë gjykim nga ana e subjektit të rivlerësimit, të marra nga sistemi bankar italian, të vërtetuara dhe të marra në formën e duhur nga autoritetet italiane, provuan faktin e kursimit të një pjese të bursës studentore, që subjekti i rivlerësimit kishte përfituar në vitin 1999 nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës Italiane, përpara datës së kthimit të saj në Shqipëri, duke e konsideruar atë të ardhur të ligjshme.

21.6. Komisioneri Publik vlerësoi se analiza financiare e kryer nga Kolegji bëri të mundur verifikimin e origjinës dhe të burimit të ligjshëm të të ardhurave të ligjshme prej 1.000.000 lekësh, të përdorura nga ana e subjektit sipas kontratës së sipërmarrjes së shtatorit 2006, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, burim i cili, sipas kësaj analize, identifikohet qartësisht në të ardhurat e ligjshme të familjes Kosova, administruar nga personi tjetër i lidhur, babai i subjektit, z. Q.K.

21.7. Në shpjegimet e datës 19.07.2019, subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, shprehu dakordësi me elementet që përshkruajnë të ardhurat e saj dhe të anëtarëve të familjes, me shpenzimet e kryera për të blerë pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe me shpenzimet për principalin dhe interesat kredie, ndërkohë që parashtrori prapësime lidhur me shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e konsumit familjar. Lidhur me shpenzimet për konsum familjar, subjekti i rivlerësimit u shpreh se Varianti II i analizës financiare përputhej me realitetin e fakteve të jetesës së familjes së saj, duke e konsideruar jetesën e familjes të thjeshtë, ku prindërit e saj, bazuar në të ardhurat e punës së tyre dhe të saj, janë përpjekur maksimalisht të realizojnë kursime, duke kryer shpenzime minimale për jetesë. Ndërsa lidhur me shpenzimet për udhëtim, subjekti i rivlerësimit parashtrori se për këtë çështje nuk ka qenë e njohur gjatë procesit në Komision për të vërtetuar lëvizjet e saj dhe të familjarëve të saj. Për këtë qëllim, subjekti vuri në dispozicion të Kolegjit deklaratën noteriale të R.V.E. të datës 30.04.2019, të legalizuar me vulë apostile të datës

¹⁷ Shih: <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes/>

¹⁸ Shih: <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-matjes-s%C3%AB-nivelit-t%C3%AB-jetes%C3%ABs/>

¹⁹ Shih: <http://www.instat.gov.al/al/temat/kushtet-sociale/anketa-e-buxhetit-t%C3%AB-familjes/#tab2>

²⁰ Shih: <http://www.instat.gov.al/en/themes/social-condition/household-budget-survey/#tab2>

²¹ Shih:

http://databaza.instat.gov.al/pxëeb/sq/DST/START__PR__PRCPI/CPI006/table/tableViewLayout2/?rxid=ea798d2-a24d-44f0-9c9c-3909a5be39bd

²² Shih <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/09/Parashtrimet-e-%C3%A7%C3%ABshtjes-dat%C3%AB-22.-7.-2019.pdf>

01.05.2019, sipas së cilës ka qenë e ftuar nga A. dhe R.E. në periudhën 24.12.2004 – 03.01.2005 dhe 24.12.2006 – 03.01.2007 dhe shpenzimet e udhëtimit kanë qenë të mbuluara, përfshirë edhe biletën e udhëtimit për periudhën e parë. Ndërsa lidhur me udhëtimin e datës 02.10.2005 – 06.10.2005, subjekti i rivlerësimit pohoi se ka qenë pjesëmarrëse në një aktivitet të Bashkimit Evropian, në kuadër të “Projektit Cards 2003”/“Regional Round Table”, i zhvilluar në Kroaci dhe se shpenzimet janë mbuluar nga organizatorët. Për këtë çështje, subjekti vendosi në dispozicion pagesën e dietave, shpenzimet personale në hotel dhe programin e aktivitetit.

21.8. Trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se kopja e noterizuar e librezës së kursimeve të lëshuar në emër të subjektit të rivlerësimit nga “Banca Nazionale del Lavoro” më datë 23.02.1999, provon kursimin nga ana e subjektit të shumës 4.480.000 lireta italiane²³. Në këtë vlerësim, trupi gjykues pati parasysh edhe faktin që subjekti rezultoi të jetë rikthyer në detyrën e saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {***} më 25 korrik 1999.²⁴ Provë tjetër që mbështeste pretendimin e saj për sa u përket studimeve në Itali në periudhën shkurt-korrik 1999, ishte edhe kopja e pasaportës, sjellë në kuadër të provave shtesë të datës 03.07.2019. Në funksion të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti solli dokumentacion që vërtetonte pamundësinë e saj për të gjetur dokumente nga komunikimi me Institutin {***} dhe me Universitetin e {***}, për shkak të periudhës kohore pothuajse 20-vjeçare.²⁵

21.9. Trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në sa më lart dhe në qëndrimet e shprehura në gjykim mbi këtë dokument nga Komisioneri Publik dhe subjekti i rivlerësimit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit vërtetoi burimin e ligjshëm të të ardhurave në shumën 1.000.000 lekë, pjesë e kursimeve nga të ardhurat e ligjshme të familjes Kosova dhe që kanë shërbyer për pagesën e kështit të parë sipas kontratës së sipërmarrjes

22. *Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik për verifikimin e rrethanave faktike e juridike dhe lidhja e tyre me subjektin e rivlerësimit, për transfertën bankare të kryer nga i vëllai (burimi i ligjshëm), trupi gjykues i Kolegjit vëren se:*

22.1. Në përgjigje të këtij shkaku ankimi dhe pyetjeve të dala nga shqyrtimi gjyqësor i Kolegjit, subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, i shoqëroi prapësimet e saj me aktet përkatëse, për të cilat, sipas nevojës së hetimit, bazuar në nenet 48 dhe 52 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi administrimin e tyre në cilësinë e provës²⁶.

22.2. Komisioneri Publik, sikundër mbajti qëndrim edhe në seancën e datës 21.6.2019, vlerën provuese të këtyre akteve e çmoi me rëndësi, pasi ato rrëzuan çdo dyshim të arsyeshëm mbi këtë transfertë bankare. Aktet e reja të administruara mbi këtë shkak ankimi provuan se transfertat e kryer nga i vëllai i subjektit të rivlerësimit në një llogari bankare jashtë vendit, në asnjë rrethanë faktike e ligjore nuk mund të lidhet me subjektin e rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, të ardhurat e saj apo të familjarëve të saj, me qëllim vlerësimin e origjinës dhe të ligjshmërisë së burimit të tyre. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, provat e administruara për këtë shkak ankimi, më së paku treguan se vëllai i subjektit të rivlerësimit ka vepruar si përfaqësues i interesit tregtar të shoqërisë, pasi në to identifikohet si llogaria bankare dërguese, ajo pritëse, përfituese në Mbretërinë e Bashkuar dhe qëllimi i saj. Situatë faktike kjo e shoqëruar me një sërë veprimesh të tjera financiare,

²³ Të konvertuar në shumën 328.339,0 lekë (kursi i datës 22.07.1999 – 1.000 lireta italiane = 73,29 lekë)

²⁴ Shih vërtetimin e lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor {***}, në paragrafin 12 të vendimit.

²⁵ Shih korrespondencën e sjellë nga subjekti me këto dy institucione në paragrafin 12 të vendimit.

²⁶ Shih paragrafin 11.2 të vendimit.

të kryera dhe nënshkruara nga vëllai i subjektit të rivlerësimit për llogari të shoqërisë, si deklarata doganore, fatura tatimore, mandatpagesa, etj. Kjo vijimësi e procesit të provueshmërisë së fakteve të sipërcituara, në vlerësimin e Komisionerit Publik mbështet pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se transferata bankare e mësipërme nuk ndikon në vlerësimin e kriterit të pasurisë së rastit konkret.

22.3. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti i rivlerësimit nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur arriti të provojë se transferata e kryer nga i vëllai i subjektit të rivlerësimit në një llogari bankare jashtë vendit, në asnjë rrethanë faktike e ligjore nuk lidhet me subjektin e rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, apo të ardhurat e saj apo të familjarëve të saj dhe, për rrjedhojë, nuk ndikon në vlerësimin e kriterit të pasurisë të subjektit të rivlerësimit. Më konkretisht, në analizën e këtij shkaku ankimi dhe në konkluzionin përkatës, trupi gjykues u mbështet në 38 aktet shkresore të sjella nga subjekti i rivlerësimit.²⁷ Trupi gjykues çmoi të provuar që z. K.K. ishte i punësuar në funksionin e juristit dhe menaxherit për mbarëvajtjen e veprimtarisë së punëmarrësit, shoqëria “{***}” ShPK, e specializuar në import-eksportin e metaleve dhe përpunimin e tyre, dhe për emër e llogari të kësaj kompanie ka kryer edhe transferata bankare jashtë vendit, drejt të njëjtit përfitues [“{***}”] dhe për emër të shoqërisë “{***}” SHPK në prill 2004.

23. *Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik për hetimin e huas së marrë nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. Q.K., ndaj shtetasit G.S., trupi gjykues i Kolegjit vëren se:*

23.1. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenet 48 dhe 52 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi administrimin e një deklarate noteriale të palëve të përfshira në marrëdhënien e huas, një sërë aktesh të lëshuara nga ZVRPP {***}, si dhe kontrata të ndryshme porosie, të nënshkruara nga huadhënësi, G.S., me qëllim vërtetimin e kohës së marrjes së kësaj huaje, qëllimin e deklaruar, origjinën dhe burimin e ligjshëm të huas²⁸.

23.2. Komisioneri Publik, në qëndrimin e tij në seancën e datës 21.6.2019, vlerësoi se këto akte të paraqitura nga subjekti, të analizuar në harmoni edhe me aktet e tjera, sqaruan mjaftueshëm këtë shkak të ankimit lidhur me kohën e marrjes së një pjese të huas në *cash*, moment i cili do të përcaktonte edhe vlerësimin ligjor nëse kjo hua do të trajtohet ose jo si e marrë nga personi tjetër i lidhur, babai i subjektit të rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016. Për Komisionerin Publik, aktet e administruara provojnë se nuk ka ndonjë indicie apo rrethanë faktike që të përfshijë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë subjektin e rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, në këtë marrëdhënie huaje, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së saj në raport me procesin e rivlerësimit.

23.3. Trupi gjykues i Kolegjit pranoi në cilësinë e provës aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, në përgjigje të këtij shkaku ankimi dhe në analizë të provave shkresore të sjella prej saj, shpjegimeve të saj dhe qëndrimit të Komisionerit Publik se këto të fundit sqaruan mjaftueshëm këtë shkak ankimi. Në rrethanat faktike konkrete, nuk u provua përfshirja e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e subjektit të rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, në këtë marrëdhënie huaje, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së saj në raport me procesin e rivlerësimit, trupi gjykues pranoi se provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit provuan mjaftueshëm mungesën e marrëdhënies së interesit, në kuptim të paragrafit 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 me këtë person.

²⁷ Shih aktet në paragrafin 11.2. të vendimit.

²⁸ Shih paragrafin 11.3 të vendimit.

24. *Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik për likuiditetet e padeklaruar të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur/tjerë të lidhur me të, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:*

24.1. Në vendimin e tij, Komisioni ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, ka qenë e saktë në deklarin e saj lidhur me likuiditetet, dhe se nga analiza financiare rezulton që ajo ka pasur mundësi ndër vite të mbledhë kursimet që kanë çuar në krijimin e pasurisë “likuiditet”, të deklaruar në deklaratën *vetting*.

24.2. Trupi gjykues vlerëson se hetimi dhe vlerësimi i pasurisë së subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, ka për objekt si kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramëve në deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, si dhe në deklaratën *vetting*, ndërsa subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur/tjerë të lidhur me të (pasuri e paluajtshme, e luajtshme, likuiditete). Subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, ka pasur për detyrë të deklaronte likuiditetet në çfarëdo forme, por nuk mund të deklaronte ato likuiditete që ishin në administrim të prindërve dhe të familjes së saj, pavarësisht nga fakti se familja mund të kishte krijuar kursime edhe për shkak të kontributit të saj me të ardhurat nga paga. Ky qëndrim i trupit gjykues merr parasysh edhe argumentet e Komisionerit Publik, që bazuar në dokumentacionin bankar, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/tjetër i lidhur me të [babai], nuk kanë deklaruar plotësisht e saktësisht likuiditetet në formën e llogarive bankare bashkëmore në deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, deri në momentin kur subjekti i rivlerësimit, si në aspektin fizik, edhe në atë ligjor rezulton të jetë ndarë nga trungu familjar, prej të cilit nuk duket të ketë deklaruar llogari bashkëmore. Edhe në fjalën përfundimtare, më datë 22.07.2019, Komisioneri Publik theksoi se ka evidentuar disa mangësi të konstatuara gjatë hetimit të çështjes në Komision, që kishin të bënin me disa elemente të kriterit të kontrollit të pasurisë, si saktësia e mjaftueshmëria e deklarin të pasurisë, qoftë në deklaratat periodike vjetore apo në deklaratën *vetting*, përmbushja e detyrimeve financiare, hetimi në mënyrë shteruese i burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë, i të ardhurave dhe likuiditeteve. Pas analizës financiare të kryer në Kolegj, Komisioneri Publik në fjalën përfundimtare u shpreh se në vlerësimin e tij, ishte verifikuar origjina dhe burimi i ligjshëm i të ardhurave prej 1.000.000 lekësh, të cilat subjekti i rivlerësimit i ka përdorur sipas kontratës së sipërmarrjes së shtatorit 2006, burim i cili identifikohet qartësisht në të ardhurat e ligjshme të familjes Kosova, të administruara nga personi tjetër i lidhur, babai i subjektit të rivlerësimit²⁹. Sipas Komisionerit Publik, vërtetohet se likuiditetet e deklaruar dhe ato të gjendura në llogaritë bankare kanë pasur si burim të vetëm të ardhurat e ligjshme nga paga e subjektit të rivlerësimit (burim i ligjshëm), bazuar në kërkesat e ligjit nr. 9049/2003 (shih edhe paragrafin 21.9). Në vlerësim të kësaj rrethane nga njëra anë, dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, të parashtruara në seancën e datës 12.06.2019, e cila paraqiti historikun e lëvizjeve në bankë referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ³⁰, nga i cili rezulton se flitet për të njëjtën shumë të qarkulluar në periudhën mes vitit 2004 deri në 2010, në banka të ndryshme, duke pasur parasysh që burimi i ligjshëm i krijimit të likuiditeteve u provua nga subjekti, trupi gjykues, ndryshe nga Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, ka pasur pasaktësi në deklarimet e saj, por në kushtet kur këto pasaktësi u shpjeguan në

²⁹ Shih parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën e datës 22.07.2019 në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2018/09/Parashtrimet-e-%C3%A7%C3%ABshtjes-dat%C3%AB-22.-7.-2019.pdf>.

³⁰ Shih fashikullin nr. 3 të Komisionit.

kuadër të marrëdhënies së saj të posaçme familjare dhe konfirmimit nga analiza financiare se familja Kosova, nëpërmjet babait të subjektit të rivlerësimit, i cili konsiderohet në këtë rast nga trupi gjykues si person tjetër i lidhur, i ka “dhuruar” shumën prej 1.000.000 lekësh, të përdorura nga subjekti për blerjen e apartamentit, vendosi ta vlerësojë këtë situatë faktike si të mjaftueshme për vlerësimin e kriterit të pasurisë.

24.3. Për sa u përket shkaqeve të ankimit lidhur me llogaritë bankare të padeklaruara të babait të subjektit të rivlerësimit deri në vitin 2010, nga analiza financiare e kryer nga trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, rezultoi se këto likuiditete [në llogari bankare] familja Kosova mund t’i kishte krijuar me të ardhurat e përbashkëta, por edhe vetëm me të ardhurat nga paga e vetë subjektit ndër vite. Gjithashtu, analiza e lëvizjeve bankare të babait të subjektit tregon se ky i fundit likuiditetet të cilat deri në vitin 2005 i kishte të investuara në bono thesari në shumën 1.900.000 lekë, në vitin 2006 i ka kaluar në llogari depozite, duke zvogëluar shumën e depozituar në 1.100.000 lekë. Në këtë kuadër, trupi gjykues vëren edhe që zvogëlimi i depozitës në vitin 2006 duket se përkon me periudhën kur babai i subjektit ka kontribuar në dhënien e shumës 1.000.000 lekë për pagesën e apartamentit. Lëvizjet bankare të likuiditeteve të babait, në vlerësimin e trupit gjykues, vërtetojnë pagesën dhe burimin e shumës së dhënë nga familja Kosova për subjektin e rivlerësimit kundrejt blerjes së apartamentit

24.4. Trupi gjykues vlerëson se hetimi dhe vlerësimi i pasurisë së subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, ka për objekt si kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve në deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë dhe në deklaratën *vetting*, ndërsa subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur/të tjerë të lidhur me të (pasuri e paluajtshme, e luajtshme, likuiditete). Në vështrim të këtij detyrimi ligjor, subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, u shpreh se këto likuiditete të administruara nga babai, ishin krijuar pjesërisht edhe nga kontributet e saj nga paga ndër vite. Në vlerësim të kësaj rrethane, analizës financiare të kryer në Kolegj (shih paragrafin 21.4. më sipër) dhe shpjegimeve të subjektit të parashtruara në seancën e datës 12.06.2019, kur ajo paraqiti historikun e lëvizjeve në bankë, referuar dokumentacionit të administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, rezultoi se flitej për të njëjtën shumë të qarkulluar në periudhën mes vitit 2004 deri në vitin 2010, në banka të ndryshme. Duke pasur parasysh që burimi i ligjshëm i krijimit të likuiditeteve u provua nga subjekti, trupi gjykues vendosi ta vlerësojë këtë shpjegim të subjektit dhe të pranojë qëndrimin përfundimtar të Komisionerit Publik lidhur me këtë aspekt, duke e konsideruar pasurinë në formën e likuiditeteve, të ardhura të përbashkëta të familjes Kosova, të krijuar me të ardhura nga burime të ligjshme.

25. *Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik nën emërtimin “Çështje të tjera”, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:*

25.1. Bazuar në provat e administruara nga Komisioni, Komisioneri Publik, konstatoi se personi tjetër i lidhur, babai i subjektit të rivlerësimit, në vitin 2000, kishte blerë një automjet me targë {***}, në shumën 880.000 lekë. Po ashtu Komisioneri parashtrroi se në fashikullin e DPSHTRr-së, ndër të tjera, gjenden të administruara akte nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim “AMF”), të cilat konfirmonin se për këtë automjet, për subjektin e rivlerësimit janë lëshuar policat e sigurimit (Third Party Liability, TPL) gjatë periudhës 2007- 2009. Në dosje të Komisionit gjenden dhe një sërë aktesh nga DRShTRr {***}, sipas të cilave subjekti kishte pasur këtë automjet në pronësi. Referuar këtyre akteve, rezultonte se subjekti i rivlerësimit nuk kishte

deklaruar në deklaratimet respektive të interesave privatë dhe pasurorë këtë automjet në pronësi apo përdorim, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie.

25.2. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të nevojave për hetim të kërkuara nga Komisioneri Publik për këtë shkak ankimi, bazuar në nenet 48 dhe 52 të ligjit nr. 84/2016, së bashku me shpjegimet e datës 12.6.2019, paraqiti tri shkresa³¹, nga të cilat rezultoi se dy policat e sigurimit për automjetin në fjalë për periudhën kohore 26.04.2007 - 25.04.2009 janë lëshuar vetëm në emër të z. Q.K. Nga ana tjetër, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, pas regjistrimit të çështjes në Kolegj³², është depozituar shkresa nr. {***} prot., datë 11.02.2019, e Komisionit, përmes së cilës Komisioni informon se pas shpalljes së vendimit përfundimtar, është depozituar shkresa e AMF-së nr. {***} prot., datë 31.01.2019 (drejtuar subjektit të rivlerësimit, për dijeni Komisionit), sipas së cilës Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, pas një riverifikimi në lidhje me sigurimet TPL në shoqërinë {***}, saktëson se, për automjetin me targë {***} rezultoi i siguruar vetëm shtetasi Q.K., përmes policës nr. {***}, për periudhën 26.04.2007 - 25.04.2008 dhe përmes policës nr. {***} për periudhën 26.04.2008 - 25.04.2009³³.

25.3. Në kushtet kur si nga aktet e administruara për efekt të hetimit në Kolegj, përkundër akteve të administruara në Komision gjatë hetimit administrativ, rezultoi se AMF-ja dhe kompania siguroese kanë pranuar ekzistencën e një gabimi material në prezantimin drejt të faktit, dhe që subjekti i rivlerësimit nuk ka disponuar policë siguri, trupi gjyqësor vëren se subjekti nuk ka pasur as detyrimin të deklarojë përdorimin e këtij mjete në deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë.

25.4. Lidhur me burimin e ligjshëm për blerjen e këtij automjeti, gjatë shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit dorëzoi dhe kërkoi nga Kolegji administrimin në cilësinë e provës të disa akteve, nga vlerësimi i të cilave Komisioneri Publik çmoi se ato provojnë, sikundër rezultoi edhe nga analiza financiare e Kolegjit, se në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai [babai] nën regjimin e ekonomisë së përbashkët familjare, ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti.

25.5. Subjekti i rivlerësimit parashtroi se babai ka pasur mundësi financiare për të blerë automjetin në vitin 2000, pasi më parë kishte shitur një tokë bujqësore të fituar sipas ligjit nr. 8053, datë 21.12.1995. Për të mbështetur këtë argument, në seancën e datës 2.06.2019, subjekti paraqiti dokumentacion provues³⁴ për të vërtetuar pronësinë e tokës bujqësore nga i ati dhe transaksione të kryera prej tij në vitin 1999 për shitjen, të cilat më pas i krijuan mundësinë financiare të blinte automjetin tip furgon në datën 31.01.2000. Në vlerësim të dokumentacionit të sjellë nga subjekti dhe të analizës financiare të kryer në Kolegj, trupi gjyqësor i Kolegjit vlerësoi se subjekti provoi me dokumentacion zyrtar që i ati ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti.

- 26.** Në përfundim, trupi gjyqësor, bazuar në konkluzionet e mësipërme, në mbështetje të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2014, vlerëson se vendimi nr. 43, datë 18.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit duhet të lihet në fuqi.

³¹ Shih paragrafin 11.5 të vendimit.

³² Datë 06.11.2018.

³³ Automjeti ka dalë nga qarkullimi si pasojë e amortizimit më datë 08.07.2010. Shih paragrafin 9.4 të vendimit.

³⁴ Subjekti paraqiti 7 (shtatë) akte për të provuar mundësinë financiare të babait për të investuar në këtë automjet. Shih paragrafin 11.5 të vendimit.

PËR KËTO ARSYE,

trupit gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, mbështetur në faktet e provuara në gjykim dhe në ligjin e zbatueshëm për çështjen, sipas nenit 66 pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 43, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, Tiranë.
2. Ky vendim është përfundimtar, me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot në Tiranë, më datë 26.07.2019.

GJYQTARE

Rezarta Schuetz

nënshkrimi

GJYQTAR

Ardian Hajdari

nënshkrimi

GJYQTAR

Luan Daci

nënshkrimi

RELATORE

Natasha Mulaj

nënshkrimi - kundër

KRYESUES

Sokol Çomo

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores, kam mbajtur qëndrim kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për çështjen (JR) nr. 30/2018, datë 06.11.2018, me ankim të Komisionerit Publik (në vijim "Komisioneri"), kundër vendimit nr. 43, datë 18.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim "Komisioni"), që i përket subjektit të rivlerësimit, Nertina Kosova.

Qëndrimin tim kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues, e mbështes në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, në ligj, prova dhe fakte të paraqitura në Komision dhe në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim "Kolegji").

- I. *Së pari*, lidhur me çështjen procedurale të kërimit përfundimtar nga ana e Komisionerit në seancën gjyqësore të datës 22.07.2019, për lënien në fuqi të vendimit nr. 43, datë 18.07.2019, të Komisionit vlerësoj se:

Qëndrimi i Komisionerit për lënien në fuqi të vendimit është i pabazuar në prova dhe i paanalizuar në mënyrë ligjore, analitike për çdo pasuri të subjektit të rivlerësimit, të cilat janë kërkuar në ankim nga ana e tij. Komisioneri në mënyrë të përgjithshme u shpreh se të gjitha shkaqet e ankimit të ngritura prej tij, gjetën përgjigje në provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të gjyqimit të çështjes në Kolegj.

Ndodhur në cilësinë e relatores së çështjes, pavarësisht qëndrimit të Komisionerit, e udhëhequr nga parimi i mbrojtjes së interesit publik, bazuar në provat e administruara në Komision dhe në Kolegj, bindjen time se subjekti i rivlerësimit, Nertina Kosova ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, vendosa të mbaj qëndrim kundër me shumicën e trupit gjykues.

- II. *Së dyti*, lidhur me zgjidhjen e çështjes në themel, nuk jam dakord me përfundimet e arritura nga shumica e trupit gjykues, për vlerësimin e kriterit të pasurisë sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 30 e vijues të ligjit nr. 84 të vitit 2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (në vijim "ligji nr. 84/2016").

1. **Për pasurinë "apartament banimi", me sipërfaqe 120 m², ndodhur në rr. "{***}", Tiranë:**

Arsyetimi ligjor dhe ekonomiko-financiar

1.1. Pasuria "apartament banimi", me sipërfaqe 120 m², ndodhur në rr. "{***}", Tiranë, është deklaruar për herë të parë në deklaratën e interesave privatë periodikë/vjetorë të vitit 2006. Në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit deklaroi ta ketë blerë apartamentin më datë 04.09.2006, përmes kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., mes subjektit dhe shoqërisë "L." ShPK, për porositjen e apartamentit në rr. "{***}", Tiranë, duke shlyer të gjithë çmimin e parashikuar në kontratë, prej 6.000.000 lekësh. Për këtë apartament, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi burim të ardhurave në vitin 2006, por në rubrikën "Detyrime financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë" deklaroi kredi banese në vlerën 5.000.000 lekë, ndërkohë që nuk deklaroi burim pasurie për vlerën 1.000.000 lekë, si diferencë mes çmimit të blerjes së apartamentit dhe kredisë së marrë pranë Raiffeisen Bank.

1.2 Në deklaratën e pasurisë të vitit 2017, për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit, Nertina Kosova, deklaroi si burim krijimi të saj, kredinë bankare në vlerën 5.000.000 lekë, pagën si pedagoge në

vitet 1995-1998, kursimet nga bursa në vlerën 4480000 lireta italiane, pagën si gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë Elbasan për vitet 1998-2004, pagën si gjyqtare në Gjykatën për Krime të Rënda Tiranë për vitet 2004-2006.

1.3 Në përgjigjet e pyetësorëve të bërë nga Komisioni dhe në shpjegimet para Kolegjit, subjekti i rivlerësimit deklaroi se shuma prej 6.000.000 lekësh, e paguar plotësisht ditën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.09.2006, ka si burim kredinë bankare prej 5.000.000 lekësh dhe 1.000.000 lekë të dhëna/kthyer nga prindërit, që përbëhet nga 600.000 lekë të tërhequra nga llogaria bankare në bankën “Societe Generale Albania”, në emër të babait z. Q.K., dhe 400.000 lekë nga *cash*-i i ruajtur në banesë nga babai si kursim nga të ardhurat familjare.

1.4 Nëse i referohemi ankimit të Komisionerit Publik për këtë pasuri, ku ngrihet pretendimi se hetimi i Komisionit është i mangët dhe i paqartë lidhur me krijimin e shumës 1.500.000 lekë, qarkulluar në dhjetor 2005, shumës 1.000.000 lekë, qarkulluar në shtator 2006 për blerjen e apartamenteve, si dhe depozitës bankare prej 1.900.000 lekësh të babait të subjektit të rivlerësimit, Nertina Kosova, për të cilat pretendon se janë pjesë e të ardhurave të kursyera nga prindërit nga kontributet e saj nga paga, në dallim nga shumica e trupit gjykues, unë si gjyqtare e mbetur në pakicë, kam vlerësuar se subjekti i rivlerësimit duhet të provonte:

i. mundësinë për të krijuar me të ardhura nga burime të ligjshme, shumën prej 1.500.000 lekësh, të paguar firmës ndërtuese “M.K.” ShPK në datën 12.12.2005, në përputhje me kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i provuar me kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2005, mes shoqërisë “M.K.” ShPK dhe znj. Nertina Kosova për porositjen e një apartamenti në Tiranë, në vlerën 6.500.000 lekë.

ii. mundësinë për krijimin e të ardhurave të ligjshme për të kryer pagesën prej 1.000.000 lekësh firmës ndërtuese “L.” ShPK, në datën 04.09.2006, në përputhje me kërkesat e nenit “D”, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i provuar në bazë të kontratës së dytë të sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.09.2006, mes shoqërisë “L.” ShPK dhe subjektit Nertina Kosova, për porositjen e një apartamenti në Tiranë, në vlerën 6.000.000 lekë.

1.5 Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se nga praktika e përcjellë nga banka “Raiffeisen”, me shkresën e datës nr. {***} prot., datë 12.06.2018, subjekti i rivlerësimit ka marrë kredi në vlerën 5.000.000 lekë, për arsye blerje apartamenti, nga firma ndërtuese “M.K.” ShPK, fakt ky i provuar në bazë të kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2005, mes shoqërisë “M.K.” ShPK dhe subjektit, Nertina Kosova, për porositjen e një apartamenti në Tiranë, në vlerën 6.500.000 lekë. Në nenin 3, pika “b”, çmimi i shitjes dhe mënyra e pagesës së kësaj kontrate sipërmarrjeje (me kushte kreditimi), thuhet se diferenca e mbetur, në shumën 1.500.000 lekë, i është paguar shoqërisë “M.K.” ShPK nga porositësi, Nertina Kosova, përpara redaktimit dhe nënshkrimit të kësaj kontrate, jashtë zyrës noteriale.

1.6 Sipas dokumentacionit ligjor në dosje, nuk rezulton që kjo kontratë të jetë anuluar mes palëve, siç pretendon subjekti dhe, për rrjedhojë, kjo kontratë mes subjektit të rivlerësimit dhe “M.K.” ShPK është në fuqi.

1.7 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit që kjo kontratë mes subjektit dhe shoqërisë “M.K.” ShPK është anuluar dhe kredia e marrë, në vlerën 5.000.000 lekë, ka shërbyer për të lidhur një

kontratë tjetër, siç është kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., mes subjektit dhe shoqërisë “L.” ShPK, për porositjen e apartamentit, nuk është i bazuar, pasi:

- i. *Nuk ka asnjë provë, siç e parashikon ligji që provon prishjen e kontratës së parë mes “M.K.” ShPK dhe subjektit të rivlerësimit dhe kthimin e vlerës prej 1.500.000 lekësh subjektit nga shoqëria. Kjo kontratë nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti dhe as shuma e paguar prej 1.500.000 lekësh nuk është deklaruar që i është dhënë/paguar shoqërisë, gjë e cila është e përcaktuar në kontratë, por është praktika e sjellë në Komision nga banka “Raiffeisen” që e vërteton këtë marrëveshje mes palëve.*
- ii. *Kredia në vlerën 5.000.000 lekë është kërkuar për t’u financuar nga banka “Raiffesien” për blerjen e apartamentit mes subjektit dhe shoqërisë “M.K.” ShPK, dhe jo siç pretendon subjekti me shoqërinë “L.” ShPK.*
- iii. *Subjekti i rivlerësimit nuk ka njoftuar bankën për anulimin e pretenduar të kontratës së sipërmarrjes me “M.K.” ShPK, duke vepruar në kundërshtim me pikën 13.1/c të kontratës së kredisë bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.12.2005.*
- iv. *Nga dokumentacioni i përcjellë nga banka “Raiffesien”, nuk provohet që kredia e tërhequr plotësisht më datë 04.01.2006 nga subjekti i rivlerësimit të ketë pasur destinacion blerjen e apartamentit nga shoqëria “L.” ShPK.*
- v. *Pretendimi i subjektit se kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “M.K.” ShPK, të lidhur më datë 12.12.2005, e ka anuluar më datë 24.12.2005 (lëshuar dorëshkrim i administratorit të shoqërisë) nuk qëndron pasi, kontrata e kredisë është lidhur më datë 17.12.2005, kredia është disbursuar më datë 27.12.2005 dhe është tërhequr plotësisht më datë 04.01.2006, përmes dy transaksioneve të tërheqjes, me 2.500.000 secili. Pra, subjekti i rivlerësimit para se t’i disbursohet kredia, nuk kishte më objekt kredie për kontratën e kredisë bankare të nënshkruar dhe ka vepruar në këtë mënyrë me keqbesim ndaj bankës, duke mos e njoftuar atë për anulimin e kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2005, mes “M.K.” ShPK dhe subjektit.*
- vi. *Me anulimin e pretenduar të kësaj kontrate, subjekti nuk mund të ishte më përfitues i kredisë me kushtet përkatëse të VKM-së për trajtim me kredi ndaj funksionarëve të lartë, por duhet të kishte riaplikuar përsëri.*
- vii. *Nuk është bindës pretendimi i subjektit që shumë cash të kredisë, prej 5.000.000 lekësh, të tërhequr më datë 04.01.2006, e ka mbajtur në shtëpi deri më datë 04.09.2006, në kërkim të një apartamenti tjetër. Kësti mujor i paguar pranë bankës “Raiffeisen” ka qenë në vlerën 23.710 lekë/muaj. Nga subjekti janë paguar këstet e kredisë për 9 (nëntë) muaj, nëse kredia nuk do të ishte tërhequr, ose do të ishte “ngrirë”, subjekti nuk do t’i paguante këto këste kredie për periudhën si më sipër. Në këtë kuptim, unë si gjyqtare e mbetur në pakicë, çmoj se pretendimi i subjektit të rivlerësimit si më sipër, nuk është bindës.*

1.8 Referuar kërkimit në ankim, deklarimeve periodike të subjektit të rivlerësimit, deklaratës së pasurisë të vitit 2017, provave në dosjen e gjykimit dhe provave të sjella në Kolegj, pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në seancë publike, nga analiza financiare për të vlerësuar mundësinë financiare të subjektit (sipas regjimit të përbashkët familjar) për të krijuar kursime në vlerën 1.500.000 lekë, për periudhën gusht 1995 deri më datë 12.12.2005, paguar shoqërisë “M.K.” ShPK, më datë 12.12.2005, rezultoi se:

Nr.	Zërat	Shuma (në lekë)
		66% të të ardhurave nga paga deri në 31.12.2002 & 01.01.2003-12.12.2005 NJEF ³⁵ /IÇK ³⁶ /QARK në vijim
(A)	Të ardhura/ hyrje (në lekë)	
1	Të ardhurat e z. Q.K., babai i subjektit të rivlerësimit	
	Të ardhurat e z. Q.K. nga pagat, firma "{***}" (gusht 1995 - mars 1996)	31462,81
	Të ardhura nga pension invalidi, z. Q.K.	678.375,31
	Të ardhura nga shtesë pensioni invalidi, z. Q.K.	49.161,29
2	Të ardhurat nga pagat, znj. Nertina Kosova	
	Të ardhura nga UAXH Elbasan, Nertina Kosova	671.904,98
	Të ardhura nga paga në funksionin e gjyqtares, znj. Nertina Kosova	4.528.735,63
	Të ardhura nga bursa MJI, Nertina Kosova (23.02.1999 - 22.07.1999), 4.480.000 ITL	328.339,00
3	Të ardhurat nga pagat, znj. B.K., nëna e subjektit	1.829.643,77
4	Të ardhurat nga pagat, z. K.K., vëllai i subjektit	23.534,86
	Bursë e përfituar nga z. K.K. (tetor 1998 – qershor 1999)	59.070,00
5	Të ardhura nga akt-marrëveshja për premtim shitblerjeje nr. 166 regj., 15.06.1999 (kapar)	850.000,00
6	Të ardhura nga interesat e depozitave/ bonove të thesarit	241.476,83
	TOTALI I TË ARDHURAVE	9.291.704,50
(B)	Shpenzime/ dalje (në lek)	
1	Shpenzime për konsum familjar	5.225.319,10
2	Blerë pasuri e luajtshme, furgon mallrash sipas kont. nr. {***} rep., {***} kol., 31.01.2000	880.000,00
3	Shpenzime për qira, paguar nga znj. N.K. (mars 2005 - 04.09.2006)	93.870,00
4	Shpenzime për udhëtime të znj. N.K. (24.12.2004 - 03.01.2005)	85.469,20
5	Paguar "M.K." ShPK, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2005	1.500.000,00
	TOTALI I SHPENZIMEVE	7.784.658,30
	DIFERENCA (A – B = Mundësia për të kursyer (D))	1.507.046,20
(C)	Kursime në llogari bankare	

³⁵ NJEF – akronim për Njësi Ekonomike Familjare, term i përdorur nga INSTAT.

³⁶ IÇK – akronim për Indeksi i Çmimeve të Konsumit.

1	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në bankë (fund - fillim viti 01.01.2001 - 31.12.2001)	492.187,11
2	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në bankë (fund - fillim viti 01.01.2002 - 31.12.2002)	-571.786,00
3	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në bankë (fund - fillim viti 01.01.2003 - 31.12.2003)	2.034.123,12
4	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në bankë (fund - fillim viti 01.01.2004 - 31.12.2004)	586.007,19
5	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në bankë (fund - fillim viti 01.01.2005 - 12.12.2005)	91.349,61
	TOTALI KURSIMEVE (LIKUIDITETE NË BANKË)	2.631.881,03
	DIFERENCA: (A – B – C) = (E) mundësia për të pasur fonde jashtë banke në 12.12.2005 para dhënies së shumës 1,5 mil. lekë	375.165,17
	Shuma e financuar subjektit nga babai më 12.12.2005 (F)	1.500.000,00
	Nëse (E) < (F): ka mungesë burimesh financiare të ligjshme; diferenca (E) – (F):	-1.124.834,83

1.9 Në përfundim të analizës financiare të kryer në Kolegj si më sipër, duke marrë në konsideratë vlerësimet e mia si gjyqtare e mbetur në pakicë, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme për të paguar shumën 1.500.000 lekë në datën 12.12.2005, në vlerën - (minus) 1.124.834,83 lekë.

1.10 Referuar shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, kërkimit të Komisionerit në ankim, provave të gjendura në dosje dhe atyre të sjella nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, në vlerësim të qëndrimeve të mia si gjyqtare e mbetur në pakicë, u krye analiza financiare për të vërtetuar nëse subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur mundësi për të kursyer vlerën 1.000.000 lekë, për periudhën gusht 1995 deri më datë 04.09.2006.

Sipas analizës financiare rezultoi se:

Nr.	Zërat	Shuma (në lekë)
		66% të të ardhurave nga paga deri në 31.12.2002 & 01.01.2003-04.09.2006 NJEF/IÇK/QARK në vijim
(A)	Të ardhura/ hyrje (në lekë)	
1	Të ardhurat e z. Q.K., babai i subjektit të rivlerësimit	
	Të ardhurat e z. Q.K. nga pagat, firma "{***}" (gusht 1995 - mars 1996)	31.462,81
	Të ardhura nga pension invalidi, z. Q.K.	761.290,60
	Të ardhura nga shtesë pensioni invalidi, z. Q.K.	75.400,00
2	Të ardhurat nga pagat, znj. Nertina Kosova	
	Të ardhura nga UAXh Elbasan, znj. Nertina Kosova	671.904,98

	Të ardhura nga paga në funksionin e gjyqtares, Nertina Kosova	5 362 971,02
	Të ardhura nga bursa MJI, Nertina Kosova (23.02.1999-22.07.1999), 4.480.000 ITL	328 339,00
3	Të ardhurat nga pagat, znj. B.K., nëna e subjektit	2 052 245,89
4	Të ardhurat nga pagat, z. K.K., vëllai i subjektit	367 409,51
	Bursë e përfituar nga z. K.K. (tetor 1998 – qershor 1999)	59 070,00
	Shpërblim si anëtar i KRRT Elbasan, z. K.K.	56 000,00
5	Të ardhura nga akt-marrëveshja për premtim shitblerjeje nr. {***} regj., 15.06.1999 (kapar)	850 000,00
6	Të ardhura nga interesat e depozitave/ bonove të thesarit	354 394,02
	TOTALI I TË ARDHURAVE	10 970 489,83
(B)	Shpenzime/ dalje (në lekë)	
1	Shpenzime për konsum familjar	6 028 030,16
2	Blerë pasuri e luajtshme, furgon mallrash sipas kontratës nr. {***} rep., {***} kol., 31.01.2000	880 000,00
3	Paguar "M.K." ShPK, sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.12.2005	1 500 000,00
4	Shpenzime për qira, paguar nga znj. N.K. (mars 2005 – 04.09.2006)	170 000,00
5	Shpenzime për udhëtime të znj. N.K. (24.12.2004 – 03.01.2005 & 02.10 – 06.10.2005) & Q.K. & B.K. në 20.05.2006)	135 914,34
6	Paguar interesa + principal për kredinë sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} prot., datë 17.12.2005	189 684,54
	TOTALI I SHPENZIMEVE	8 903 629,04
	DIFERENCA (A – B = Mundësia për të kursyer (D))	2 066 860,79
(C)	Kursime në llogari bankare	
1	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në bankë (fund - fillim viti 01.01.2001 - 31.12.2001)	492 187,11
2	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në bankë (fund - fillim viti 01.01.2002 - 31.12.2002)	-571 786,00
3	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në bankë (fund - fillim viti 01.01.2003 - 31.12.2003)	2 034 123,12
4	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në bankë (fund - fillim viti 01.01.2004 - 31.12.2004)	586 007,19
5	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në bankë (fund - fillim viti 01.01.2005 - 12.12.2005)	99 598,20
6	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në bankë (fund - fillim viti 01.01.2006 - 04.09.2006)	619 731,91
7	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në bankë (pas tërheqjes 600 000 lekë më 04.09.2006)	-600 000,00

TOTALI I KURSIMEVE (LIKUIDITETE NË BANKË)	2.659.861,53
DIFERENCA: (A – B – C) = (E) mundësia për të pasur fonde jashtë banke më 04.09.2006, pas tërheqjes së shumës 600.000 lekë nga banka, para dhënies së shumës 1.0 milion lekë	-593.002,74
Shuma e financiar subjektit nga babai më 04.09.2006 (F)	1.000.000,00
Nëse (E) < (F): ka mungesë burimesh financiare të ligjshme; diferenca (E) – (F):	-1.593.000,74

1.11 Në përfundim të analizës financiare të kryer në Kolegj si më sipër, duke marrë në konsideratë vlerësimet e mia si gjyqtare e mbetur në pakicë, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme për të paguar shumën 1.000.000 lekë në datën 04.09.2006, në vlerën - (minus) 1.593.000,74 lekë.

1.12 Në qoftë se shpenzimet e jetesës për subjektin dhe personat e lidhur, i llogarisim sipas standardit të Komisionit, përsëri subjekti i rivlerësimit nuk i justifikon shpenzimet dhe krijimin e kursimeve që, në fakt, asnjëherë nuk i ka deklaruar. Në këtë version të përlogaritjes vetëm të shpenzimeve, ndërkohë që zërat e tjerë të analizës financiare nuk ndryshojnë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë në vlerën 548.060,60 lekë.

1.13 Si gjyqtare e mbetur në pakicë, kam kundërshtuar vendimin e shumicës që vlerëson të përlogarisë shpenzimet për konsum familjar, ku sipas metodologjisë së përdorur nga shumica, shpenzimet për konsum përbëjnë vetëm 19% të të ardhurave, ndërkohë që 81% e të ardhurave shkojnë për kursim, e cila është një vlerë shumë e lartë kursimi në raport me pagat jo të larta që ka përfituar subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, gjatë periudhës së analizuar, gjë e cila duket pothuaj e pamundur. Edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit në seancë gjyqësore publike, se shpenzimet për konsum kanë qenë dhe më të ulta, në vlerën 12% të të ardhurave, është një pretendim absurd, pasi rezulton se një pjesëtar i familjes Kosova të ketë jetuar mesatarisht me 1.800 lekë në muaj.

1.14 Referuar analizës së mësipërme, në dallim nga shumica e trupit gjykues, kam krijuar bindjen që subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për të paguar këstin e parë në vlerën 1.500.000 lekë, sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 12.12.2005 dhe pagesën në vlerën 1.000.000 lekë, sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 04.09.2006.

1.15 *Në përfundim të gjithë sa më sipër, arrij në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të pasurisë duke fshehur pasurinë, sipas nenit 33, pika 5, shkronja "c" e ligjit nr. 84/2016 dhe ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë sipas nenit 33, pika 5, shkronja "b" e ligjit nr. 84/2016.*

2. Për transfertën 22.350 USD, të kryer nga vëllai, z. K.K.

2.1 Referuar pretendimit në ankim të Komisionerit për hetimin e transfertës 22.350 USD të vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. K.K., më datë 06.04.2005, duke qenë se vëllai i subjektit në këtë datë ka qenë pjesë e certifikatës familjare, rrjedhimisht pjesë e ekonomisë së përbashkët

familjare, së bashku me subjektin e rivlerësimit e, për pasojë, person i lidhur me të në kuptim të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016.

2.2 *Lidhur me këtë transfertë*, nga subjekti i rivlerësimit u paraqitën në Kolegj disa akte, të cilat me vendim të ndërmjetëm u morën në cilësinë e provës. Pavarësisht bisedimeve përfundimtare të Komisionerit, në dallim nga shumica e trupit gjykues, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë përmes provave të paraqitura në Kolegj faktin që kjo transfertë ishte kryer në emër dhe për llogari të shoqërisë “A.P.” ShPK. Kjo, për faktin se:

- i.** Nga subjekti i rivlerësimit u paraqit në cilësinë e provës një kontratë pune e datës 23.01.2003, lidhur midis shoqërisë “A.P.” ShPK dhe z. K.K., por subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor nëse për këtë marrëdhënie pune ishin paguar apo jo tatimet dhe sigurimet shoqërore. Duke qenë se në cilësinë e provës gjenden në dosjen e gjykimit edhe të dhënat nga ISSh, rezulton se për këtë marrëdhënie pune nuk janë paguar sigurimet shoqërore, çka e bën të dyshimtë ekzistencën e kesaj marrëdhënieje.
- ii.** Nga dokumentet bankare rezulton se transfera prej 22.350 USD ose prej 2.196.215,11 lekësh është kryer nga llogaria personale e vëllait të subjektit të rivlerësimit, z. K.K., në drejtim të shoqërisë “M.I.”, me përshkrimin transfertë personale. Për sa më sipër, kam arritur në përfundimin që kjo është një transfertë personale e vëllait të subjektit të rivlerësimit dhe, si e tillë, ajo duhej përfshirë në analizën financiare si shpenzim i kryer nga familja Kosova.
- iii.** Të gjitha shpjegimet e subjektit në Kolegj nuk janë bindëse, lidhur me transfertën e të vëllait K.K., pasi çmoj se sipas bindjes sime të brendshme, se indiciet e dhëna nga subjekti në seancë gjyqësore, në tërësinë e tyre nuk janë bindëse.
- iv.** Sipas arsyetimit të mësipërm, duke marrë në konsideratë këtë transfertë të vëllait të subjektit, analiza financiare do të rezultonte me mungesë burimesh financiare të ligjshme për të kryer pagesën 1.500.000 lekë shoqërisë “M.K.” ShPK, në datën 12.12.2005, në vlerën 3.321.049,94 lekë. Ndërkohë që për të kryer pagesën e kështit 1.000.000 lekë, në favor të shoqërisë “L.” ShPK në datën 04.09.2006, analiza financiare do të rezultonte me mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 3.789.217,85 lekë.

3. Për huan në vlerën 7.000.000 lekë, të marrë nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. Q.K., ndaj shtetasit G.S.

3.1 Referuar si shkak në ankim nga Komisioneri, lidhur me këtë hua, unë si gjyqtare relatores mbetur në pakicë, kam konstatuar së pari se nga Komisioni është kryer një hetim jo i plotë, si dhe nuk ka gjetur pasqyrim në vendim rezultati i këtij hetimi. Pavarësisht hetimit të kryer nga Komisioni lidhur me personin huadhënës G.S., qoftë në drejtim të kriterit të kontrollit të figurës ashtu edhe në drejtim të aftësisë huadhënëse (pagueuse) të tij, në vendimin përfundimtar Komisioni nuk ka evidentuar asnjë fakt lidhur me këtë hetim. Në përgjigje të këtij hetimi jo të plotë nga subjekti i rivlerësimit u paraqitën disa akte të cilat, me vendim të ndërmjetëm të trupit gjykues, u morën në cilësinë e provës.

3.2 Kam konstatuar se huaja në vlerën 7.000.000 lekë është marrë nga z. Q.K. prej shtetasit G.S. përmes kontratës së huas nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.07.2011, pa interes, me detyrimin për t'u kthyer brenda datës 07.07.2021, pra me afat 10 vjet, si dhe me përcaktimin se, nëse kjo

shumë nuk kthehet brenda afatit, sërish nuk do të aplikohet asnjë normë interesi deri në shlyerjen totale të shumës.

3.3 Në kontratë gjithashtu përcaktohet se shuma prej 4.000.000 lekësh do të likuidohet përmes një banke, ndërkohë që shuma prej 3.000.000 lekësh i është dhënë huamarrësit Q.K. paraprakisht në cash.

3.4 *Për pretendimin e Komisionerit Publik se nuk është hetuar plotësisht lidhur me kalimin e shumës 3.000.000 lekë, pjesë e huas, pavarësisht bisedimeve përfundimtare të Komisionerit Publik lidhur me këtë shkak ankimi, vlerësoj se momenti i kalimit të kësaj pagese lidhet me faktin e të qenit ose jo person i lidhur, në kuptim të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, të babait, z. Q.K., me subjektin të rivlerësimit, Nertina Kosova. Kjo, pasi kontrata e huas për vlerën 7.000.000 lekë është lidhur më datë 08.07.2011, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit është shkëputur nga trangu (certifikata) familjar i origjinës më datë 27.05.2011, dhe se kontrata e huas për vlerën 7.000.000 lekë parashikonte që vlera prej 3.000.000 lekësh ishte dhënë paraprakisht. Deklarata noteriale e shtetasit G.S., e lëshuar gjatë gjykimit në Kolegj, ku deklarohet se vlera prej 3.000.000 lekësh është dhënë në të njëjtën datë me lidhjen e kontratës së huas, merret me rezervë për përmbajtjen e saj, pasi ajo nuk provon ekzistencën e faktit.*

3.5 Për mundësinë financiare me të ardhura nga burime të ligjshme për dhënien e huas nga shtetasi G.S., nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. {***} prot., datë 22.03.2018, është konfirmuar se shtetasi G.S. është ortak në disa shoqëri, por nuk rezulton të ketë shpërndarë dividend apo të ketë realizuar fitim deri në vitin 2011.

3.6 Gjithashtu, lidhur me huan e marrë nga babai, z. Q.K., ndaj shtetasit G.S., në vlerën 7.000.000 lekë, sa i takon përdorimit të kësaj shume, nuk është i saktë, pasi nga aktet e administruara konstatohet se më datë 08.07.2011, është xhiruar shuma prej 4.000.000 lekësh nga huadhënësi G.S. në llogarinë rrjedhëse të huamarrësit, babai i subjektit, z. Q.K., dhe menjëherë pas një muaji, më datë 09.08.2011, huamarrësi Q.K. investon në “bono thesari” me maturim njëvjeçar, shumën 4.000.000 lekë dhe jo për qëllim të blerjes së njësisë së shërbimit nga shtetasi I.Rr. (kunati i babait të subjektit të rivlerësimit), siç ka deklaruar kur është pyetur nga Komisioni mbi këtë marrëdhënie huaje të të atit.

3.7 Për sa më sipër, kam arritur në përfundimin se shtetasi G.S. duhej të kualifikohej si person tjetër i lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për sa i takon vlerës pjesore të huas, në shumën 3.000.000 lekë, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë aftësinë huadhënëse të shtetasit G.S. me të ardhura nga burime të ligjshme. Në këtë kuptim, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave në përputhje me nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

4 Për gjendjen e likuiditeteve

4.1 *Në lidhje me shkakun e ngritur në ankim për mosdeklarim të likuiditeteve ndër vite, kam konstatuar se nga ana e subjektit të rivlerësimit:*

i. nuk është deklaruar në asnjë nga deklaratat periodike të pasurisë llogaria bankare dyemërore në shumën 300.000 lekë fillimisht, hapur në vitin 2003 dhe mbyllur në vitin 2008. Në të njëjtën kohë, nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2008, një shumë prej 303.972 lekësh në llogarinë personale të subjektit më datë 13.11.2008, transfertë e realizuar nga babai i

subjektit, i cili, sipas subjektit të rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit nr. 4 të Komisionit, këtë shumë e kishte tërhequr nga llogaria e përbashkët që ai kishte me subjektin e rivlerësimit. Pavarësisht se llogaria bankare ka qenë dyemërore e përbashkët, në fund, e gjithë shuma e kësaj depozite i është transferuar subjektit të rivlerësimit nga i ati, në llogarinë e saj personale.

ii. nuk është deklaruar llogari rrjedhëse në bankën “Raiffeisen” në vitin 2006, në vlerën 268.958 lekë, në vitin 2007 në vlerën -24.874 lekë, në vitin 2008 në vlerën 80.239 lekë, në vitin 2009 në vlerën 23.205 lekë, në vitin 2010 në vlerën 126.158 lekë, dhe në vitin 2011 në vlerën 22.633 lekë.

iii. nuk është deklaruar në vitin 2009 llogaria bono thesari e subjektit të rivlerësimit në shumën 500.000 lekë, përmes bankës “Raiffeisen” (15.09.2009).

iv. nuk është deklaruar në vitin 2010 llogaria bono thesari e subjektit të rivlerësimit në shumën 700.000 lekë përmes bankës “Raiffeisen” (18.08.2010).

4.2 Në përfundim, për këtë shkak ankimi, çmoj se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë sipas nenit 33, pika 5, shkronja "c" e ligjit nr. 84/2016.

Për gjithë sa shpjegova më sipër, referuar kriterëve që ka parashikuar Kushtetuta dhe ligji mbi vlerësimin e pasurisë për subjektet e rivlerësimit, si dhe duke mbajtur standardin e përgjithshëm që ka përdorur Kolegji, çmoj se trupi gjykues duhet të kishte vendosur ndryshimin e vendimit nr. 43, datë 18.07.2018, të Komisionit dhe shkarkim nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Nertina Kosova.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtarja Rezarta Schuetz, nuk bie dakord me arsyetimin e anëtarëve të tjerë të shumicës, për dy çështje.
2. Së pari, lidhur me detyrimet që u njeh ligji subjekteve deklaruese, të parashtruara në pjesën e arsytimit që lidhet me pretendimin e Komisionerit Publik për likuiditetet e padeklaruar të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur/tjerë të lidhur me të në llogarinë dyemërore që ka pasur me të atin deri në vitin 2008.
3. Mendimi i anëtarëve të tjerë të shumicës, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, [...] nuk mund t'i deklaronte ato likuiditete që ishin në administrim të prindërve dhe të familjes së saj, pavarësisht nga fakti se familja mund të kishte krijuar kursime edhe për shkak të kontributit të subjektit me të ardhurat e saj nga paga. [...] ³⁷, bie ndesh me faktet dhe me ligjin. Llogaria bankare në fjalë është llogari dyemërore në Bankën "Raiffeisen", në emër të subjektit të rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, dhe të atit, z. Q.K., hapur në dhjetor të vitit 2004.

Arsyetimi i anëtarëve të tjerë të shumicës do të ishte i pranueshëm nëse këto likuiditete ishin në administrim të familjes dhe subjekti i rivlerësimit nuk ishte në dijeni apo nuk ishte pjesë e llogarisë dyemërore. Asnjë prej këtyre rrethanave nuk vlen në rastin konkret pasi, sipas konfirmave bankare të administruara në fashikull gjatë hetimit, me shkresën e Bankës "Raiffeisen", të administruar nga Komisioni të datës 11.01.2018, me nr. prot. {***} (fashikulli 2, faqe 293-294), konkretisht, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur depozitë dyemërore me babanë, e cila nga viti 2004 deri në vitin 2008 nuk është deklaruar së bashku me ndryshimet e saj, shtesat ose pakësimet.

4. Sipas nenit 4, pika 1, germa "d" e ligjit nr. 9049/2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar:

"Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendjen në *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]"

5. Kurse formulari i deklarimit periodik vjetor i këtij ligji në faqen 3, te "Ndryshimet e pasurisë dhe burimet e krijimit", në mënyrë të detajuar udhëzon:

"Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni të çdo lloj pasurie, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit".

6. Qartësisht, formulari kërkon nga deklaruesit të përshkruajnë me hollësi, ndër të tjera, edhe ndryshimet, vlerën në lekë apo valutë, adresën ku ndodhen, llojin dhe pjesën takuese të çdo pasurie. Së dyti, ky deklarim i detajuar duhet të përfshijë edhe burimin e krijimit në kolonën e majtë,

³⁷ Paragrafi 24.2 i vendimit.

“Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit”. Për pasojë, duke qenë së në këtë rast flitet për një depozitë dyemërore, një prej mbajtësve të së cilës ishte edhe subjekti i rivlerësimit, është përtej diskutimit që subjekti i rivlerësimit duhet ta deklaronte atë në vlerën e saktë, pjesën takuese dhe vendin ku këto likuiditete ishin depozituar, burimin e krijimit të depozitës, si edhe shtesat ose pakësimet e saj.

7. Dispozita më sipër dhe formulari nuk lënë shteg për të interpretuar që nëse likuiditetet janë në administrim, huapërdorje apo ruajtje të dikujt tjetër, subjektet deklaruese përjashtohen nga detyrimi për t'i deklaruar.
8. Për më tepër, fakti që këto kursime ishin të vetë subjektit të rivlerësimit është pohuar qartë dhe në mënyrë të përsëritur nga kjo e fundit në përgjigjet e pyetësorit të dërguar me *e-mail*-in e datës 07.06.2018, fashikulli 9, në pyetjen 2. Këtë argument, subjekti i rivlerësimit, znj. Nertina Kosova, e përsëriti në shpjegimet e saj të datës 12.06.2019 në KPA (faqet 5 dhe 6) dhe të datës 22.07.2019, në fjalën përfundimtare në KPA, në parashtrimin me shkrim (faqe 2), duke ngulmuar se këto të ardhura rrjedhin nga pagat e saj.
9. Edhe pse në proporcion me rrethanat e tjera – vërtetimin e burimit të ligjshëm për këto të ardhura të përdorura nga personi tjetër i lidhur, babai i subjektit për të paguar një pjesë të pagesës së apartamentit në pronë të saj – unë votova me shumicën për mënyrën e zgjidhjes së këtij shkaku ankimi, arsyetimi i anëtarëve të tjerë të shumicës, përveçse bie ndesh me ligjin e aktet nënligjore për deklarimin e interesave privatë, krijon paqartësi te subjektet deklaruese për zbatimin e një dispozite fare të qartë për mënyrën se si duhet të deklarohet pasuria, përfshirë edhe likuiditetet.
10. Sipas interpretimit të anëtarëve të tjerëve të shumicës, administrimi i likuiditeteve të subjekteve nga të afërm apo individë të tretë, i çliron subjektet nga detyrimi për të deklaruar sipas ligjit, për sa kohë likuiditetet, qoftë edhe pjesërisht, janë në kujdestari apo administrim të dikujt tjetër.
11. Së fundmi, kjo mënyrë interpretimi padrejtësisht ndërhyr dhe prish rregullat e bazuara në ligjet mbi të cilat ka funksionuar e funksionon deklarimi i pasurive dhe i interesave privatë.
12. Së dyti, në arsyetimin e anëtarëve të tjerë të shumicës, përfshirë edhe në paragrafin 24.2., rezulton të jenë referuar në mënyrë të përsëritur gjithë hapat proceduralë dhe kërkesat e ngritura nga Komisioneri Publik në lidhje me këto likuiditete. Ndërsa riprodhimi në detaj i kërkesave të parashtruara nga Komisioneri Publik, lidhur me vlerësimin e tij se “ishte verifikuar origjina dhe burimi i ligjshëm i të ardhurave të përdorura sipas kontratës së sipërmarrjes [...], burim i cili identifikohet qartësisht në të ardhurat e ligjshme të familjes Kosova, të administruara nga [...] i ati i subjektit të rivlerësimit [...]” dhe që “[...] likuiditetet e deklaruara dhe ato të gjendura në llogaritë bankare kanë pasur si burim të vetëm të ardhurat e ligjshme nga paga e subjektit të rivlerësimit”, është i saktë, nga ana tjetër, në këtë pjesë të arsyetimit mungon referimi te vendimet e marra nga trupi gjykues i Kolegjit në përgjigje të këtyre pretendimeve të Komisionerit, që përfshinin edhe hetimin e kryer nga trupi gjykues në funksion të vendimmarrjes. Një mënyrë e tillë përshkrimi duket se i rezervon gjykatës një rol pasiv, në funksion vetëm të kërkesave, parashtrësive dhe në shërbim të Komisionerit Publik, gjë që bie ndesh me rolin drejtues që parashikojnë neni F, pikat 1, 2, 3, 5 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pjesa VII “Procedurat e rivlerësimit”, nenet 45 deri në 53 dhe nenet 65, 66, 67. Përkundër gjithë detyrimeve që ligji i njej Kolegjit të Posaçëm të Apelit në dispozitat e mësipërme, gjuha e Kushtetutës dhe

e ligjit, tagrat e Institucionit të Komisionerëve Publikë i kufizon te dispozitat që parashikojnë ankimin kundër vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, konkretisht neni C, pika 2 dhe neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 63 dhe 64 të ligjit nr. 84/2016.

13. Një lexim harmonik i këtyre dispozitave, atyre që përmbajnë detyrat e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe atyre që parashikojnë detyrat në procesin e rivlerësimit të Komisionerëve Publikë, vërteton se Kolegji përveçse gjykata e vetme në proces, ka detyra specifike dhe konkrete në “[...] mbledhjen e fakteve dhe provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit [...]”³⁸ dhe një sërë veprimesh të tjera të karakterit aktiv në kërkimin e provave, sipas neneve 45, 48, 49, 50, 51, 52 dhe 53 të ligjit nr. 84/2016.
14. Për këto arsye, mendoj se në arsyetimin e mësipërm të anëtarëve të tjerë të shumicës, veprimet procedurale dhe analiza e hetimet e trupit gjykues duhet të ishin pasqyruar gjerësisht dhe saktësisht, në funksion të rolit që ka Kolegji i Posaçëm i Apelimit në zbatim edhe të nenit C, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës që parashikon: “[...] Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre bazuar në parimet e llogaridhënies, integritetit dhe transparencës për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional, të çliruar nga korrupsioni. [...]” dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës që parashikon: “[...] Kolegji i Posaçëm i Apelimit përbëhet nga shtatë gjyqtarë dhe është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit, sipas këtij Aneksi dhe ligjit. [...]”.

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

³⁸ Neni F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.